

Intervistë me Mexhid Sylën

Prishtinë – Data: 16 Mars, 2025

Kohëzgjatja: 194 minuta

Të pranishëm

1. Mexhid Syla (I intervistuari)
2. Edmond Syla (Intervistuesi)

Pjesa e parë

Edmond Syla: Po fillojmë me bisedu për fëmijerinë tane, prindërit dhe qysh ka qenë ajo kohë për ju?

Mexhid Syla: Jom i lindur me 15.11.1948 në fshatin Shakovicë, prej nanës Hanife dhe babës Sylë {pauzë ca minuta}, ne atë kohë kemi qenë bashkësi familjare me të ndjerin gjyshin Fazlin dhe axhën Abazin dhe Behxhetin, ai ka vdek më vonë, ndërsa me Abazin kemi jetu deri në vitin '70 apo '69, kemi nda bashkësi familjare.

Sa i përket fëmijerisë, si çdo fëmijë i fshatit, nuk kemi pas probleme te theksume sa i përket ushqimit, sekondare dhe primare, mirëpo të themi se kemi pas një standard të lart, atë nuk e kemi pas dhe besoj që nuk e ka pas në atë kohë askush apo kanë qenë te rralla, dhe në fshatrat nuk e kanë pas askush.

Edmond Syla: Çka e karakterizon këtë kohë dhe këto kriza?

Mexhid Syla: Viti 1948 njihet si viti i i krizave më të rënda ekonomike që ka qenë në Jugosllavi në kuadër të së ciles kemi qenë na si Kosovë, ka qenë krizë për bukë dhe atëherë shteti ka urdhëru bujqit me një lloj takse që është dashte një pjesë të prodhimeve bujqesore, misrit, grurit, etj. me i nda për shtet, dhe ajo ka qenë në aso përmasa që është dasht edhe familjen me lon keq për ushqim, e shtetit me i përmbush gjithëqysh atë obligim varësisht prej sipërfaqes së tokës që ke pas.

Edmond Syla: Po ju dhe familja, si e keni përjetu këtë periudhe?

Mexhid Syla: Për me i ikë asaj situate, bujqit kanë vepru në mënyra të ndryshme për me fsheh, kanë pas raste që ne brenda shtëpise, mrenda dhomës, që ka qenë pak më e madhe, e kanë bo një mur

tjetër si muri anësor por e kanë bo mrena, dhe atë pjesë në mes murit anësor dhe asaj e kanë fsheh grurin apo misrin për momente të rënda.

Edmond Sylja: Çka i ka karakterizu këto momente të rënda për ju?

Mexhid Sylja: Unë nuk e kom përjetu këtë situatë personalisht, mirëpo e kom dëgju nanën time, duke e treguar e ndjera gjyshja që shumë familje, një pite që e kanë qitë, një laknor ose diçka, atë petë të laknorit e kanë përdorë deri në tre herë për me u ushqy, se nuk kanë pas miell, edhe njerzit kanë shku për një kilogram miell me punu tërë ditën te dikush që ka qenë më i pasur. Kështu që ka qenë një situatë shumë e rëndë. Më vonë baba është punësu në hekurudhë si punëtor fizik, ka punu tokën dhe ka fillu me u marr me tregëti, ku e karakterizon një situatë të rëndë ekonomike, mirëpo kemi pas një jetesë solide dhe nuk kemi vuajt për ushqim.

Si fëmijë, shkollën fillore e kom kry në Lluzhan dhe tetë vjeçaren, ku së pari kemi qenë në Lluzhan ku ka qenë krejt dy klase, është zhvillu mësimi për klasat nga 1 deri në 4 dhe më vonë është bërë një zgjerim i shkollës nga ish objekti i kooperatives bujqësore që dhuroi disa dhoma për shkollën derisa u ndërtua shkolla që është edhe tani në Lluzhan, që atëherë është quajtur shkolla “29 Nëntori” e sot quhet “Afrimi e Fahriu” (pauze).

Në ato kushte jemi mundu me mësu, i kemi pas disa mësues që janë edukue me kurse të ndryshëm, me njëqind peripeci, po sidoqoftë jonë mundu që me dhonë maksimumin për me përcjellë diçka prej diturisë së tyre dhe sendev elementare, dhe për fat të keq, në krahasim me tash çka po shohim e qysh po zhvillohet porcesi mësimor, ka ndërru krejt situata tash. Megjithatë ka qenë një përkujdes shumë i madh me kujdesin ndaj nxënësve, dhe kom vetëm lavdata dhe respekt për ta.

Edmond Sylja: Kur the që ka ndërru situata sa i përket procesit mësimor, çka nënkupton me këtë?

Mexhid Sylja: Pas kryerjes së tetë vjeçares kemi pas një situatë të rëndë në familje ku ka vdekë axha Behxhet, dhe ishte problem që të marr leje me vazhdu shkollimin më tutje.

Edmond Sylja: Çka e vështërisoi këtë?

Mexhid Sylja: Me qenë i singert, baba nuk pengojke dhe ishte i interesum në këtë lëmi, por gjyshi me çdo kusht kundërshtojke duke pytë se ku me shku kur nuk ka kush me u kujdes për bageti dhe punën. Edhe pse isha i vogël me moshë unë fillova me i ndihmu mixhës Abazit dhe babës me i kry punët e bujqësisë.

Edmond Sylja: Çka e ka shty gjyshin që mos me leju shkollim tutje?

Mexhid Sylja: Ka qenë një botëkuptim primitiv ku rolin më të madh e ka lufta feja, predikuesit e fesë, hoxhallarët tonë që kanë qenë aq te prapambetur, sa që une besoj që nese ka diçka në ate bote, ata nuk kanë ku jetojnë përveç se në ferr, dhe atë në nivelin më të lartë.

Dhe jo vetëm atë, por ka pasë edhe mendime të tilla ku tregonin se, nëse fëmija shkollohet, bëhet shka, nuk bën më me u vesh mirë, e sidomos ajo rreth femrave, ku nuk bën me shku në shkollë dhe se duhet me u mbulu gjithqysh. Probleme që e kemi përjetu dhe që kanë ndiku keq në jetën tonë.

Edmond Sylja: Çfare ndikimi kanë pas këto mendime dhe predikues te fesë në familjen tuaj?

Mexhid Sylja: Patjetër që kanë ndiku. Rasti konkret është axha apo gjyshi i juaj, ka qenë një prej nxënësve më inteligjentë në shkollën fillore, [por] nuk e lanë të vazhdojë më tutje. Por pas shumë vitesh filloi me u rritë vetëdija dhe u bënë disa përpjekje me u zhvillu kushtet, që të hapen disa kurse nëpër oda dhe vende të ndryshme. Aty mbaheshin mësim nga mësues, që pasuan me shkolla nate për personat që kanë mbetë, si gjyshi yt e mixha im, Abazi. Ku iu mundësua të mësoj në shkolla nate brenda një periudhe më të shkurtër, ku iu mundësua të kryejë tetëvjeçaren. Dhe ashtu, mixha e përfundoi atë shkollim, si shumë të tjerë, ku duke iu falenderu qasaj shkolle, janë regjistru në gjimnaz ose në normalen dhe e kanë kry shkollën e mesme. Ku disa kanë punu, e besa kanë vazhdu me shkollim të lartë. Kjo është kaptinë në vete që don një trajtim më të gjerë dhe të lartë, por ky ka qenë realiteti jonë.

Edmond Sylja: Mbetëm te pjesa e shkollimit të mesëm. Si arrite të vazhdoni tutje?

Mexhid Sylja: Shkova në Prishtinë të regjistrohem në gjimnaz, u regjistrova {një ndjenjë kënaqësie në sytë e tij shfaqë emocione}, ku me ato kushte, që kishim dhe probleme të natyrave të ndryshme.

Edmond Sylja: Cilat kaë qenë sfidat gjatë këtij rrugëtimi?

Mexhid Sylja: Fillimisht është dasht me udhëtu me tren. Ka qenë treni i udhëtarëve që është quajti “Lokal” nga Prishtina në Fushë Kosovë dhe në Podujevë, dhe zakonisht në pesë ora të mëngjesit është nisë nga Podujeva për në Prishtinë. E na kemi dalë në Lupç, një fshat tjetër ku ishte stacioni i trenit, apo në Lluzhan që është quajti “*Malo Kosovo*” apo “*Kosova e Vogël*”, ku nuk kishte rrugë, nuk kishte dritë, ku lumi ka vërshu shpesh dhe dilte nga shtrati i tij. Nëpër baltë e nëpër shi e kemi kry shkollën, së bashku me disa shokë nga katuni, që disa prej tyre kanë punu në Ramiz Sadik.

Ku me atë tren kemi shku në Prishtinë, e ka ndodhë shpesh që kur kemi hyp në tren kemi qenë të përbaltun. Po fati i mirë ka qenë që në atë tren ka pasur ujë të nxehtë në tualet, edhe e kemi shfrytëzu atë ujë me u pastru. Dhe për fat të mirë ka pas edhe nxemje në tren, e jemi afriu me u ngrohë sado pak, kurdo që kemi pas mundësi me u afriu te nxemja, sepse ka qenë kallabllak i madh, ka pas shumë njerëz në tren. Dhe kemi mri diku në Prishtinë rreth orës 5:30 dhe drejt kemi shku në Shadërvan të Xhamisë së

Madhe. Në verë, dimër, atje kemi shku, dhe kemi marrë pak bukë me vete, kush ka pas mundësi, dhe kemi hangër bukë aty, e kemi pritë deri në orën 8 kur edhe u hap shkolla.

Kur jemi te kushtet, unë sot kur i shoh fotografitë, kur i shoh si nxënës, shihet që jam i mbathur me opinga të gomës. E aty në gjimnaz ka qenë karakteristike se aty në gjimnaz kanë shku fëmijët e funksionarëve të asaj kohe, fëmijët e qytetarëve, e ne të katunit kemi qenë më të diskriminuar. Me një fjalë, nuk po thom që na kanë diskriminu ata, por ishim të veshur dobët, pa ushqim, të paqethur... {një lloj frustrimi, pasi që ka një ngritje të tonacionit të zërit}, si fmi katunari, thjesht, që është dashtë me u zgju në ora 5, e ai [qytetari] është zgju në ora 7 dhe ka ardhë në gjimnaz nga blloku, në mësim. E qeshtu ka qenë kjo situatë.

Edmond Sylja: Si ka ndiku kjo te ju edhe te edukimi yt?

Mexhid Sylja: Po, si nuk ka ndiku! Kur kthehesh nga shkolla rreth orës 4 ose 5, nga Prishtina me tren, është dashtë që menjëherë të merrem me bagëti që kemi pas, edhe një libër me vete, duke u mundu me mësu diçka gjatë asaj kohe. E në mbramje nuk kemi pas energji elektrike, po kemi pas disa llampa gazi. Po, gjyshi ka qenë interesant, se nuk lejke me çu fitilin shumë lart për me bo dritë ma shumë, për shkak se harxhojke gaz më shumë. Kur u ulshim ndonjëherë te llampa {tregon me duar pozitën që ka zënë}, gjyshi thojke, “Qe derki i thiut edhe këtë dritë që e kem po na e nxen!” Krejt këto kanë qenë gjëra që kanë reflektu në mësim, por ka ekzistuar një vullnet i madh dhe jemi mundu, dhe kemi bo çdo gjë që me mbërri me kalu klasën.

Klasën e parë e kom kalu, por në klasën e dytë e kom humb vitin në gjimnaz. Edhe nuk e kom fsheh këtë gjë asnjëherë, e i kam thënë edhe nipave e mbesave, kurdo që kanë pasur ndonjë krizë apo qortim nga prindërit, apo ndonjë depresion. Thoja që duhet me pas kujdes edhe me mësu sa të mundeni, mirëpo mos e merrni tragjike nëse keni marrë ndonjë notë të dobët një herë, se unë e kom humb vitin krejt, po mandej e kom dhënë gjithçka, e kom kry gjimnazin në ato kushte, edhe kom regjistru fakultetin. Nuk kom mujt me e kry në qershor, po kom diplomu në shtator, domethonë mrena 4 viteve e kom përfundu fakultetin. Kur jemi te fakulteti, kjo situatë ka qenë përafërsisht sa i përket situatës teme.

Edmond Sylja: Para se me fillu me bisedu për fakultet, deshta me të pytë qysh e ka pritë familja humbjen e vitit në gjimnaz?

Mexhid Sylja: Nuk më kanë bo problem, e kanë kuptu situatën. Kur jemi te humbja e vitit, është karakteristike se atë vit, mos të them që 100%, por me siguri 80% të fëmijëve që kemi qenë nga fshatrat kemi humb vitin. Mundem me i përmend edhe me emra, me Tefik Lec, me Ismale, me Selatin e shumë të tjerë që e kemi humb vitin. Edhe ka qenë një farë diskriminimi, një kriterium më i ashpërsum, sikur kur dojnë me na largu neve. Nuk mundem me akuzu individualisht askënd, mirëpo ka qenë një

tendencë e jashtëzakonshme. Edhe në disa raste, sikur që ndodh edhe tash, në disa raste që kom dëgju, kur vendosin nota të dobëta për ata, e kalon fëmija i qytetit.

E kom kalu mandej gjimnazin, e jom regjistru në fakultet. Kom bo çdo gjë që me mujt me arritë qëllimin dhe ja kom dalë me e përfundu dhe me u regjistru në fakultet, e kjo falë familjes, edhe posaçërisht nanës që ka bo gjithçka. Shembull, ajo asnjëherë nuk ka ra me fjetë derisa unë kom qenë me libër në dorë, qoftë sa isha në gjimnaz apo në fakultet, poashtu edhe në shkollë fillore. Si sot më kujtohet kur isha te shkronja “L”, nuk mujsha me mësu atë njësi mësimore. Lexova e lexova disa herë edhe kisha probleme me e thonë, dhe fillova me qa. E nana më tha, “Çka u bo?” I thashë që nuk po mundem me mësu, e nana më tha, “Pse po qan? Mos kaj, po merre, shtine librin nën kry, edhe të garantoj që nesër ke me ditë.”

Edhe për Zotin ka ndodhë ashtu si ka thanë nana. Të nesërmen e kom ditë atë njësi mësimore si papagall. Ka qenë diçka “L” e madhe e shtypit, “l” e vogël e shtypit, “la la, lo lo”, në atë kohë që ka qenë {bën shaka duke kujtu me nostalgji si memorje}. Po e apostrofoj posaçërisht babën, që i ka pas problemet e veta rreth mbijetesës, bujqësisë dhe tregtisë, që është marrë për me na siguru një mirëqenie si familje. E kjo është sa i përket shkollës fillore.

E për gjimnaz thashë që për herë të parë e kom mbajtë dhe e kom përjetu me ma ble një sako të re, kur kishim me u bo gati për maturë, në vitin e fundit... [një pauzë e gjatë]. Për me u ndërlidh te aspekti fetar, në atë që e theksun që kemi pas probleme, në vitin ‘66-‘67 është botu libri i Marlin Barletit “Historia dhe luftërat e Skënderbeut”, dhe ishim kureshtarë, me atë skamje e me ato probleme. Nga paret që i kom marrë për ushqime a diçka, i kom nda, dhe nuk kom ditë qysh i kom siguru ato pare, për me qenë i singurtë, por e kom ble atë libër dhe disa libra tjerë që jon botu në atë kohë. Edhe kur erdh puna në vitin e katërt me zgjedhë temën e diplomës, e zgjedha temën e historisë, me këtë temë.

Nji ditë isha duke lexu në odë, ku ka qenë e shtrume me sexhade e tepiha, e isha shtri në bark me lexu. Edhe baba e çeli derën, rahmet i pastë shpirti {kujton me mall}, e tha, “Çka po bon?” I thashë, “Po lexoj.” Tha, “Çka po lexon, çka është ai libër aq i madh?” E i thashë, “Është për Skënderbeun.” Ai e ngriti zërin, “ÇKAAAA! Për Skënderbeun?!” E përsërita, “Pasha Zotin.” Tha, “Ta shoh edhe një herë në dorë pa të bo llom me gjith to, s’e lo!”

E unë e disha ku e ka ai. Se kur bisedojshim për çështjen e Skënderbeut, ishte aktuale, si ashtu, shkuarja në Hënë e astronautëve amerikanë, e jo në Amerikë, e anën e knej e këto... ishin bisedat që zhvilloheshin zakonisht në oda. E baba thojke kategorikisht që “ai u kanë qafir, katolik, e ka luftu kundër muslimanëve” [ka fjalën për Skënderbeun]. E krejt këtë ndikim e ka pas feja, predikimi i keq dhe predikimi i gabum i prijësve të fesë dhe hoxhollarëve tonë në atë kohë. E tash unë nuk po du me u lëshu më tutje, se ka pas edhe sot njerëz që i mbajnë mend prej asaj kohe, ku ka provë që imam i një xhamie ka qenë një person që u shkollu, me prejardhje rus apo serb, dhe ka arritë me u bo imam i një

xhamie. Pra, e ka pas rolin e caktum veç me na ligjër, me na lon mbrapa, mos me u zhvillu dhe me na pengu në edukim. Tjetër nuk po di çka me tregu.

Edmond Syl: E përmendet situatën familjare që keni pas në atë kohë, si vdekja e disa familjarëve para regjistrimit në fakultet. Si ka ndiku kjo në vazhdimin e shkollimit?

Mexhid Syl: Siç thashë edhe më herët, unë kam qenë punëtor dhe nuk është që ka pas ndonjë ndikim shumë të madh. Se kur e kom kry mësimin, jom kthy në shpi, e vikendeve s'kom pas kohë as me mësu, ose me dalë diku, po ton kohën ose e kom ruajtë bagëtinë, ose është dashtë me ju bashkangjitë axhës dhe me i ndihmu me çkado që kom pas mundësi, edhe me të ndjerin vëllaun, Abitin. E familja ime normal që ishin të kënaqur që unë po e kryj fakultetin, e nana më ka nejtë gati me ushqim, e natën mos me lon me shku pa hangër bukë.

E kom hongër atë ushqim, e ashtu kom shku në mësim. E nganjëherë, kur përgatitej buka e grytë, mas fshirjes së grurit, ma dhojke një bukë dhe një copë djathë në atë çantën ku kisha librin. E për me ble e me u ushqy në qytet, nuk po thom asnjëherë, mirëpo të rralla kanë qenë ato momente, se nuk ka pas, edhe nuk e fajësoj kërkon për atë, se ashtu ka qenë situata. Sidoqoftë, ashtu kemi vazhdu, edhe e kom kry. E erdh koha me u regjistru në fakultet, e babgjyshi ka kundërshtu, po baba tha, “Jo, nuk e veti kërkon, po djali ka me shku me u regjistru.” Edhe kom vendos me u regjistru në Fakultetin Juridik.

Kom pas andërr edhe dëshirë me regjistru në një fushë filozofike, logjike apo psikologji, pasi që isha i mirë në ato dhe i kom dashtë, edhe i kom lexu me ëndje. Por nuk munda me u regjistru aty, e shkova në Juridik.

Pjesa e dytë

Edmond Syl: Për çfarë arsye e zgjodhe Fakultetin Juridik?

Mexhid Syl: Të them të drejtën, isha i interesum me kry fakultet, edhe këto shkenca ekzakte nuk kom qenë i prirun. Bile pata me tregu një rast me profesorin e ndjerë Sabri Hoxhën, ku më nxoni tu kopju edhe ke kah ma humb të drejtën e shkollimit krejt, po pshtova, e nuk po hi manena. E kom qenë i prirun për lëndë shoqërore, se nuk kom pas problem me lëndë ekzakte si matematikë, fizikë e kimi, [po] është dashtë me lexu e me punu. Nuk jam pendu që e kom zgjedhë këtë fushë.

Kom shku në fakultet, i dorëzova dokumentet te referenti që ka qenë një malazet i quajtur Millan. I mori, i kqyri, folke shqip, e tha, “O ti djalë, diçka qetu pasha mixhën nuk është në rregull.” Thashë, “Pse more, çka po mungon?” Tha, “Qetu në diplomë po shënon Mexhid Berisha, e në *izvod* [certifikatë e lindjes] Mexhid Syl. Nuk bon kështu,” tha, “duhet me kanë njejtë”. “Po qashtu,” thashë, “e kom kry shkollën, e certifikatën e kom nxjerr në oficeri”. “Po, po,” tha, “duhet me kanë njejtë”. “E çka me bo?”

tash. Tha, “Duhet me ndërru njonën.” Për me nxjerr certifikatën e me ndrru mbiemrin, u kanë procedurë, një mujë ditë ka zgjatë. Nuk ka pas shans përpara me e kry atë punë.

E me të thanë të drejtën, jom dalë përjashta, edhe ja kom nisë me kajtë {një pauzë e shkurtër}, se ishte afat shumë i shkurtër për me i kry ato punë e me bo zgjidhje. E kanë thanë, “Të priftë e mos i prifsh”, domethonë, në jetë është shumë me rëndësi edhe fati me të ecë. E unë pata fat aty, që qelloi një drejtor, ushtrues i detyrës, një malazez poashtu. Në gjimnaz e pati zëvendësu profesorin e ndjerë Idriz Rexhën, u kanë drejtor shkolle, për të cilin kom respekt të jashtëzakonshëm.

Tash prapë po kthehna në atë rreth gjimnazit. Me ardhjen e tij si drejtor i gjimnazit, neve sadopak na janë kriju do kushte për neve, fëmijëve të fshatit. Na ka caktu një sipërfaqe, një dhomë në bodrum, edhe e ka shti një stufë, edhe i ka siguru do ulëse për me u ulë edhe me mujt me u nxeh. Edhe ujë ka pas, edhe me hongër bukë, edhe me u pastru. Edhe masi e kryjshim shkollën në 12 ora, deri në 3 ose 4, që thashë ma herët që kthehej treni për në katun, kemi nejt aty.

Atë na e ka mundësu Idrizi, që kemi pas respekt shumë të madh për të. Përveç disiplinës edhe rendit që e ka pas, për ato sene mo mos të flasim. {një pauzë e gjatë, kur fillon t’i bashkojë duart, duke menduar dhe disi reflektuar mbi atë periudhë, që pasohet me tregime të tjera}

E tash kur jemi te gjimnazi prapë, se nashta po zgjerohna pak, po më duhet me e cekë, që në gjimnaz, deri në vitin e dytë, ma shumë se 50% të lëndëve i kemi pas në gjuhën serbo-kroate. Mas vitit të dytë ka fillu me u shtu numri i mësimdhënësve, profesorëve shqiptarë.

Landë bazike: Gjuhën shqipe, matematikën... Besnik Fazliu historinë, fizikën Hamdi Spahiu, kiminë jonë ndrru të ndryshëm, si Maliq Osmani, Nafije Mekaj. Në Gjuhën Shqipe, Kajtaz Rrecaj. Pra, filloi me u rritë numri.

Edhe gjimnazin kur e kemi përfundu, përveç gjuhës serbe, vizatimit, edukatës fizike, e nuk e di, katër ose pesë landë që kanë qenë ma sekondare, të tjerat i kemi pas në gjuhën shqipe krejt.

E tash po kthehna te ajo rreth diplomës e certifikatës. “Çka me bo?”, thashë. Dola, edhe e hupa... mo s’kom shansë. Edhe me të vërtetë nuk kisha pas shansë ma me i hy asaj pune. Po fati e deshti ashtu. Edhe më ra në mend, shkova te drejtori, ushtruesi i detyrës, Uksanoviq, një malazez i gjatë, me siguri dy metra, i hëshëm. Ka qenë i njohur për korrektësi, edhe sa ka qenë zëvendës i drejtorit, por edhe masi u bo ushtrues i detyrës, nuk kemi pas kurrfarë problemi me të. {një pauzë e shkurtër për mbledhjen e mendimeve}

Edhe hina në derë, serbisht normal, se e kom ditë serbishten, se kemi pas serbë këtu fqinjë edhe e kemi mësu serbishten, s’e kemi pas problem. Po i tregoj, kështu, kështu, kështu... [përsërit disa herë, duke lënë të kuptohet se ishte një shpjegim i gjatë mbi problemin që kishte].

Më tha, “Çka don me bo?” I thashë, “Nuk e di,” veç i thashë që ndihmë tjetër ma të madhe për mu nuk munesh me bo. I thashë, “Nëse nuk e kryj tash këtë regjistrim, unë po të garantoj që mo kurrë në jetë nuk muj me u regjistru në fakultet, as me shku, se qashtu i kom rrethanat në familje.”

Ai u mendu, e u mendu, e tha, “Shko, bleje një formular të diplomës, të zbrazët, edhe dëftesën e vitit të katërt” apo të katër viteve sa kom qenë në gjimnaz, po nuk jom i sigurt. Amo diplomën që e kom plotësu me dorën tem edhe sot e kom të ruajtun.

Më tha, “Shko, plotëso diplomën, e këtë *izvodin* (certifikatën në shqip) ma len mu këtu, te kom në dosje tane.” E kom plotësu diplomën qysh ka qenë, veç e kom bo Mexhid Syle Sylja.

Edmond Sylja: Qysh ka ardhë deri te ndryshimi i mbiemrit, që si pasojë kanë rrjedhë këto probleme?

Mexhid Sylja: E tash, s’e di a e njeh ti Jonuzin, një kushëri i joni qetu?

Edmond Sylja: Jo, nuk e njoh.

Mexhid Sylja: Ai e ka pas kry diçka, shkollën apo artin, edhe shkojke ushtar, e ishte i vetmi që kishte kry diçka shkollë, e na e kemi kqyrë si shembull, si idoll. Derisa ishte ushtar, u mundu me kalu kufinin e me dalë në Shqipni, e e burgosën. Edhe doli fjala, Jonuzi, i burgosun politik, edhe Jonuz Berisha.

Edhe unë qaty, tani kur jom regjistru në tetëvjeçare, e kom ndërru, e kom bo Jonuz Berisha, Mexhid Berisha. E qaty jom kanë ka ja shoh sherrin asaj pune.

I kom marrë ato, ja kom çu, i ka vulosë krejt, e me nënshkrim të tij, i kom edhe sot e asaj dite. Edhe shkova, i dorëzova, u regjistrova, edhe qysh thashë, e kom kry fakultetin mrena katër viteve. Në qershor nuk kom mujt me diplomu, po kom diplomu më 3 shtator 1972.

Edmond Sylja: Si ka qenë kjo periudha e fakultetit dhe tranzicionit nga shkolla e mesme?

Mexhid Sylja: E fakulteti tash është histori në vete. Në fakultet, kur jemi regjistru në vitin e parë... Ma së pari, se kjo veç filloi mas ‘68, se kom qenë në gjimnaz. Mas gjimnazit, në të vërtetë, si student kom marrë pjesë në demonstratat e ‘68-ës. Edhe filloi kadal-kadal, me ramjen e Rankoviqit në 1966, filloi te na kapak me u vërejtë një përmirësim dhe një lehtësim i situatës. Nuk kish mo torturë ndaj njerëzve në ato përmasa që kemi pas. Nuk i kishim të drejtat që na takojshin krejt, mirëpo, megjithatë, filloi me u përmirësu situata.

Në fakultet, në vitet e para, kemi pas lëndë, prapë po thom, pjesën dërrmuese i kemi pas serbisht. Lëndën kryesore, për shembull, po i referohna të Drejtës Romake, na e ka dhanë doktor Ivo Puhani,

autori i librit, edhe një profesor me renome ndërkombëtare, ish-profesor në Fakultetin Juridik në Shkup. Normal, na fillim me kërkim... në fakt na u mundësu regjistrimi, pra numër i pakufizim në fakultet, veç i kemi çu dokumentat, edhe nuk ka pas as provim, as test. 270 e diçka kemi qenë të regjistruar në vit të parë në Fakultetin Juridik në atë kohë. Ka qenë senzacion, ka qenë, fakultete private s'ka pas atëherë.

Nuk kishim ku me i maktë ligjëratat. Ligjëratat i mbajshim në amfiteatrin e Fakultetit Filozofik, ku ka qenë një amfiteatër i madh, e aty i kemi mbajtë ligjëratat krejt. Fillim ligjëratat, u mundojshim me mësu, në ndërkohë kërkujshim, edhe fillim me u organizu e protestu me na u siguru profesorët në gjuhën shqipe. U morëm vesh që të njëjtën gjë me bo edhe me Ivo Puhani {profesori i të Drejtës Romake që u përmend më parë}, me profesorin e respektum.

Erdhëm në ligjëratë, plot amfiteatri, dhe u morëm vesh që një koleg me u çu. Ka qenë Destan Rukiqi, qashtu u përcaktum. Filloj ulun të gjithë. Ai i hapi shënimet e veta çka i kishte, edhe na përshëndeti, e u përshëndetëm me të. E tha, “Profesor, a mundem diçka me thonë?”

“Urdhëno,” tha “koleg”. Tha, “Po më vjen keq me thonë në emër të kolegëve, po na mo ligjëratat nuk dojna me i dëgju te ju. Na i dojna ligjëratat në gjuhën tonë.” Edhe na, menjëherë, reagime spontane, “Poooo! Po, po, po!” [e thotë në atë mënyrë sikur kthehej në atë kohë, duke e zgjatur zanoren “poooo” disa herë].

Madhështia e një intelektualit, e një doktori, as me u skuq, as me shpreh ndjenjë nervoze, as ndjenjë arrogante, por vetëm me një buzëqeshje dashamirëse, tha, “Kolegë,” tha, “ok,” tha, “unë veç po du me ju thanë diçka.”

Tha, “Bëhuni të bindun që nuk kom ardhë ‘iz moralnih pobuda’, prej motivit material” [e citon atë që kishte thënë profesori Ivo Puhani], “me jau mbajtë ligjëratën për këtë landë. Kom ardhë se më kanë lutë me ardhë, se nuk ka pas kush me jau mbajtë ligjëratat për këtë landë. E po thom me sinqeritetin ma të madh që kisha me qenë njeriu ma i lumtun nëse bohet një zgjidhje dhe gjendet dikush që me jau mbajtë ligjëratat në gjuhën e juaj.

E aq sa kisha me qenë i lumtun, sa ta kisha ditë gjuhën e juaj e me mbajtë këtë ligjëratë unë, me përfundu në gjuhën e juve. Përndryshe, qëndrimet e juaja i respektoj, edhe guximin e juaj e respektoj shumë.” Edhe veç i ka palu letrat e i ka shti në çantë {bën me gjeste se si i ka palu letrat}, edhe “Ju dëshiroj çdo të mirë”, edhe ka dalë.

E kemi vazhdu, kanë ardhë profesorë shqiptarë, anena e knena. Jo s'ka zgjedhje, jo dekan, jo rektor, e jo... se filloi ajo me marrë përmasa të mëdha. Ka ardhë, e kemi përfundu vitin me të [bëhet fjalë për profesorin Ivo Puhani]. E ato reagime dhanë sukses, se një gjeneratë e re e disa profesorëve, Ragip Halili, Ilmi Smajli, Kabil Merovci e plot të tjerë që nuk po më kujtohen me emër, kanë ardhë. Si kanë

diplomu, nashta edhe pa i kry krejt formalitetet, do do k'si kurse e trajnime, edhe kanë ardhë, e na i kanë mbajtur landët si asistentë ose si ligjërues.

Edhe kështu ka vazhdu puna, e në fund u bënë profesorë krejt, me Gazmend Zajm, me Hajrend Hoxhë, Syljan Popovci, thashë Ragip Halili... kanë qenë kjo prirade e profesorëve të mrekullueshëm. Për shembull, Gazmend Zajm i kemi thanë *tokfillë*, qaq ka qenë një profesor i jashtëzakonshëm, me një intelegjencë, me një diapazon të jashtëzakonshëm të diturisë. Historinë e shtetit dhe së drejtës, Esat Stavileci, e ai tjetri, e ai tjetri... dhe kështu ka vazhdu.

Edmond Sylja: E përmende fjalën *Tokfille*, a mundesh me na tregu çka domethënë kjo fjalë?

Mexhid Sylja: Një filozof... E kemi kry fakultetin. E sa i përket kushteve aty, gjatë tanë verës, asnjëherë nuk kom pas shansë me nejt në konvikte.

Edmond Sylja: Pra, gjatë studimeve keni qëndruar në konvikte e nuk keni udhëtuar?

Mexhid Sylja: Po, mirëpo nuk kom pas shansë me nejt në konvikte gjatë verës. Është dashtë me ardhë... Jom martu në 1970 edhe u ndamë prej gjyshit edhe mixhës, qysh tham në fillim. Nuk kishim kulm mbi krye, e u dasht me bo shpi, e çka i duhet një familje, me i bo kadal-kadale. Me vllaun Abitin kemi pre tulla e blloka, baba me tregti... e ashtu e kemi pas një mirëqenie deri diku. Nuk kemi vuajtë për asgjë. Derisa kemi qenë në gjimnaz, kemi qenë gjeneratë shumë aktive. Kemi reagu çdo herë nëse janë cenu të drejtat, si rezultat, qysh thashë ma herët, ke përmirësimi i strukturës së ligjëruesve.

Edmond Sylja: A mundesh me marrë ndonjë rast konkret kur keni protestu dhe si ka shku?

Mexhid Sylja: Po si jo, po si jo! Protesta ka qenë mas vitit '70. Filluan disa lëvizje në krejt Jugosllavinë. Ka qenë një protestë e madhe e studentëve të Universitetit të Zagrebit, edhe jo veç e studentëve, por edhe e disa intelektualëve, si Stjepan Mesić, që ka qenë kryetar i Jugosllavisë dhe i Kroacisë në fund, Mika Tripalo, e një garniturë e intelektualëve kroatë, që kanë kundërshtu. Edhe ata e kanë shprehë një revoltë mbi gjendjen në ish-Jugosllavi, thjesht, një proces që tregonte që nuk mundet me qenë Serbia ajo që duhet me vendosë për krejt, me pas primatin të atij sistemi.

Na fillum me i mbajtur lidhjet me studentët e Zagrebit. Filluan mandej edhe serbët me kundërshtu, edhe me pas reaksione kundër asaj që ndodhke atje. Madje ka pas edhe protesta të studentëve në Beograd, çdo njeri për arsye të ndryshme të vetat. Edhe një ditë ishim në bufe, ka qenë Osman Kryeziu, tanimë i ndjerë, Baki Krasniqi, Qazim Qerimi, unë (Mexhid Sylja), Nazim Hyseni, edhe nuk e di edhe kush tjetër, edhe thanë që janë hi studentat serbë në amfiteatër, edhe diçka po diskutojnë kundër neve.

Jemi çu ai grup edhe kemi shku te dera. *Tak, tak, tak*, atë derë, nuk e çelshin. *Tak, tak, tak*, atë derë, prapë nuk e çelshin {bën me zë sikur troket në derë}. Ja nisëm me e rreh derën me grushte, edhe fillun dikur me u tubu edhe profesorat, se e ditën që u bo diçka. Edhe u kriju një rremuje. I kemi dhonë zor, e kemi shty derën me shpinë, edhe e kemi qitë prej vendi, e kemi hi brenda.

E kur kemi hy brenda, ka qenë një student duke folë diçka. Edhe e kom përcjellë atë studentin me letër, edhe ju kom vërsul atij. Jo që kom qenë trim, po ma dha Zoti qashtu, po edhe e kemi pas një guxim, se vetë fakti që depërtum aty, e tanë ajo masë knap u kanë, plot u kanë, amfiteatri. Edhe kom shku, ju kom afër, “Ama atë letër.” Ai tha, “*Nema ništa.*” [nga serbishtja: “Jo, nuk ka asgjë”] Prapë i thashë, “Ama atë letër.” Tha, “Nuk ta jap.”

Ka mrrit shoku jem, Baki Krasniqi, rahmet i pastë shpirti, ka punu si gjykatës më vonë. Edhe u kanë korpulent dhe i guximshëm, edhe nuk ka pritu me u rreh hiç, s’ka pritu [e thotë me një bindje të plotë]. Duart nalt, “Nanën, kështu, kështu ta bofsha!”, edhe ia ka çu shkau duart nalt, edhe ja kom shti dorën me ja marrë letrën me dorën teme.

Ka ardhë dikush prej profesorëve edhe më tha, “Ama, Mexhid, atë letër!” I thashë, “Jo, këtë letër munet me marrë veç Nazmi Mustafa.” Profesori ka qenë llapjan, qetu i joni, që e njifsha ma afër dhe kisha besim me ja dhon atij. Hyjnë, u mush aty plot, edhe ja kom dhonë atë letër Nazmis. Nuk e kom lexu çka ka pas, po ja kom dhonë Nazmis atë letër. Edhe u bo rremuje. Ata dolën me përhapë konflikte, me u kap, e na dolëm te një ndërmjetëse, në mes Fakultetit Juridik dhe atij Ekonomik, edhe u tubuam aty. Nuk u largojshim. E profesorët dolën anena e knej, derisa fillun me na nda në grupe.

Na thojshin: “Ju e krytë punën e juve, ja arritët qëllimit, ja ndalët tubimin. Largohuni tash, se po e shihni çka është situata, ju marrin e ju burgosin.” Është e vërtetë që i kemi dëgju, edhe jemi largu. E kjo është një prej rasteve të shumta. Poashtu kemi protestu edhe s’kemi leju me u zgjedhë dekan i Fakultetit Hajredin Hoxha, por kemi kërku me u zgjedhë i ndjeri Mark Krasniqi.

Edmond Sylja: Për çfarë arsye nuk lejuat me u zgjedhë Hajredini, por Marku?

Mexhid Sylja: Kishim një ndjenjë që ishte më atdhetar edhe ma i mirë, andaj edhe e kemi kundërshtu, edhe e kemi bojkotu, derisa u kry edhe ajo punë, u zgjodh Mark Krasniqi dekan i Fakultetit Juridik. E atëherë kemi qenë Fakulteti Juridiko-Ekonomik, bashkë kanë qenë, një fakultet, mirëpo ligjëratat janë mbajtur veç e veç.

Edmond Sylja: E përmend këtë letrën që e morët nga studentët serbë, por që nuk e keni lexu. A keni kuptuar më vonë se çfarë përmbajtje kishte ajo letër?

Mexhid Sylja: Jo, se na kapluan ngjarjet e ndryshme atë kohë, vazhdimisht do ndodhi të ndryshme. Një herë ishim duke pritë te Zejnullah Gruda, ndjesë pastë, edhe ai u kanë profesor i mrekullueshëm.

Ishim duke pritë derisa ka hy në provim, se kemi pas të drejtë që studentët shqiptarë, nëse nuk e kanë ndi veten mirë te profesori shqiptar, kanë mujt me hi te profesori serb me dhanë provimin, edhe anasjelltas, edhe serbi ka mujt me dhanë provimin te shqiptari. Kështu që kur pritshim aty, kishte edhe serb, edhe shqiptarë.

Po bisedojmë, aty ishte ky vlugi i ngjarjeve që po ndodhte atëherë, edhe njëni po reagon, që nuk e kishim pa kurrë te ligjëratat te serbët, e tha, “Kolegë, çka po ju duhen studentat kroat kur e keni nanën në Serbi?” I kthehem, “Çka?!” {duke e rritur tonin e zërit} edhe normal, reaguam na aty edhe e ofenduem, e krijuam rrëmujë aty, po ai heshti edhe u tërhoq, doli përjashta. E na fillum me bisedu qysh na la hile-kile, çka u bo, ka shkoi... edhe dolëm me lypë me Maliq Dushakun, që ka vdekë edhe ai, edhe po e shohim që kish dalë në atë pjesën e fakultetit ekonomik, në katin e dytë, në dritare.

“*Zdravo kolega, šta radiš?*” (Përshëndetje koleg, çka po bën?) Edhe i thash, “Hajde, të bisedojmë rreth asaj ma herët, çka na the ‘*majka Serbia*’, t’i sqarojmë pak do sene. Ai tha, “Po, kurgjo s’është bre me atë punë, kolegë, e anena e knena,” edhe u mundojke me u tërhekë me ato fjalët e veta. E na ja shtim dorën, njona anena e njoni knena, edhe e qitëm në oborr. E kur dolëm aty, ishte edhe Baki, nuk ka pritë hiç, veç i ka ra boks [shoku temperament që e përmendi edhe ma herët], “Nanën, kështu-kështu ta bofsha!” Edhe i kemi ra krejt, kush çka ka mujt, deri në momentin që e nxorri revoltën, e ka repërtit [sa ishin aty e sulmuam serbin, deri në atë momentin kur revolta ngjalli frikë dhe traumë ndër vite], edhe e morëm vesh që ka qenë punëtor i Sigurimit.

Sefedin Hyseni ju ka afriu ballë për ballë edhe i tha, “Gjuje, të pshurrsha në pistoletë!” Po nuk ka shkrep ma tutje, edhe na u tërhoqëm, po nja dy javë s’kemi guxu me shku në fakultet.

Pjesa e tretë

Kur thash që kom marrë pjesë në demonstratat e ‘68-ës, normal aty u burgosën shumë e ku ta di unë, e fillun ka pak me u interesu kush u kanë. Edhe një ditë kur u ktheva prej fakulteti, veç isha regjistru në fakultet, baba tha, “U kanë bre ti djalë dikush me të lyp edhe kanë thanë me u lajmëru ose vime apat.”

Edmond Syl: Në polici?

Mexhid Syl: Po, normal, u merakos. E tani nuk më ka lon baba me shku në ligjërata nja dy muaj, kurrë pa e marrë një gujë [xhakëtë e trashë], edhe thojke, “Merre këtë gujë se ti nuk e din çka është burg,” se baba u kanë në burg disa herë.

Edmond Syl: Për çfarë arsye ka qenë në burg?

Mexhid Sylja: Një arsye ka qenë për shkak që ka ikë prej ushtrisë së Jugosllavisë, që e kanë marrë me zor në front, por jo për diçka tjetër. Por edhe na ka shënu që si familje jemi në sy të keq prej pushtetit, në dosje të shtetit. Edhe kur e kom marrë në ushtri dokumentin, apo nuk e di ku, më patën thanë që rrjedh prej një familje që gjithmonë ka pas probleme me pushtet.

Edmond Sylja: Në çfarë aspekti kanë qenë këto probleme, më shumë politike apo diçka tjetër?

Mexhid Sylja: Po, po, mirëpo më vonë nuk kom pas probleme. Tash nuk mundem pa e thanë, mirëpo ajo periudhë [bëhet fjalë për vitin 1968] e kanë bo këtë kthesë edhe me kontributin e tyne. Vazhdimisht kanë ndryshu, ku qëllimi jonë ka qenë me shprehë revoltën për statusin dhe kushtet në të cilat jemi kah jetojmë. Edhe ka fillu ashtu, prej asaj demonstrate, ngadalë-ngadalë me parashtrimin e këtyne kërkesave.

Ka ardhë Tita, e ka vizitu Kosovën [Tito ka qenë president i Jugosllavisë në atë kohë] edhe sot mundet me u gjetë fjalimi i tij kur thotë në një takim të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, “Është e vërtetë që kemi bo dhe kemi arritë një përparim të dukshëm në Kosovë, mirëpo ka edhe shumë gjana që kanë mbet pa u bo edhe duhet me u bo.” Edhe këto kanë fillu dalë-ngadalë, Kushtetuta në ‘74, flamuri, qashtu, universiteti na u leju se na kemi qenë Fakulteti Juridik-Ekonomik si Universiteti i Beogradit, e ma vonë janë bo këto sene e fillun me u avancu.

Aq largpamës kanë qenë sa kanë mundësu që me u regjistru numër i pakufizum i studentëve edhe kanë dalë kuadra që prej asaj gjenerate teme. Na jemi edhe sot ajo gjeneratë që edhe sot takohemi në një datë të caktume, edhe kemi në Maqedoni që kanë pas pozita deri në rang të ministrit, poashtu në Preshevë e Bujanoc, e në të gjitha komunat e Kosovës ka pas kuadra që kanë qenë ose gjyqtarë, ose prokurorë, ose kryetarë kuvendi, edhe në pozita të ndryshme çka janë në lëmi të jurisë.

Edmond Sylja: I përmende pozitat e ndryshme që kanë pas kolegët, po ju si e filluat karrierën tuaj profesionale?

Mexhid Sylja: Sa i përket biografisë teme, pas kryerjes së fakultetit, normal, jom interesu menjëherë me u punësu, me i ndihmu familjes, edhe kom bisedu me dajën Fetah. Daj, thash, “E kom kry fakultetin.” Ai më ka përqaftu e më tha, “Urime e u gëzofsh!” E i thash, “Me mujt me hi në punë diku, dajko.” Kom bisedu me Faik Halilin, se isha bursist i Fondit Krahniar për bursa dhe kredi. I kemi pas obligim na me u lajmëru në atë fond edhe me punu një kohë sa e ke shfrytëzu bursën, sa të caktojnë ata. Jom shku te Faik Halili, ka qenë drejtor i Fondit. Ai më tha, “Po daj, e kryj,” amo nuk e kryjti, se ka pas qejf me dhanë fjalë, po nuk më punësoi.

Kom bisedu me dajën Fetah, e tha, “Po bre daj, po bisedoj, qysh jo, po bisedoj me Raif Gashin,” u kanë Kryetar Komune në Podujevë. Edhe shkon e bisedon edhe thotë që, “Po more, ka nevojë në gjyq, po a është anëtar i partisë?” E i thashë, “Jo valla, çfarë partie daj?” Ai tha, “Jo valla, Raifi tha kështu,

kështu...” [duke tregu rregullat që ishin për me pas një pozitë publike]. Edhe i kanë organizu qeto strukturat e Lluzhanit, daja Fetah kuptohet, me insistimin e tij, edhe nëse s’gaboje, mrena tri dite ma kanë prurë librezën që jom anëtar i partisë.

Edmond Sylja: Pse ka qenë e rëndësishme me qenë anëtar i partisë?

Mexhid Sylja: Në strukturat që ishin në atë kohë, për me qenë gjykatës ose me pas ndonjë pozitë publike të rëndësishme, është kërku ajo. Me kanë pranë në parti, e kom shku me apliku edhe në mbledhjen e parë të Kuvendit, Mexhid Sylja zgjidhet gjykatës i Gjykatës, jo gjykatës, por pranohet praktikant i Gjykatës Komunale në Podujevë. I ndjeri Mustafë Shala ka qenë kryetar i gjykatës, edhe jom shku, ja kom nisë punës, edhe ai më tha, “Po ja bojmë Shala.” Mas gjashtë mujve që kom punu si praktikant, mue më kanë zgjedh gjykatës pa e dhënë provimin e judikaturës, mirëpo e kom pas kusht që mbrenda një viti me dhënë provimin e judikaturës edhe e kom përmbush atë kusht. Edhe kom vazhdu, kom punu tri vjet në Podujevë si gjykatës.

Edmond Sylja: Qysh ka qenë kjo periudhë për ty, prej një studenti në praktikant e më vonë gjykatës?

Mexhid Sylja: Unë mendoj që ka qenë një ndër periudhat më të mira të jetës tem. E tash, mos të harroj, si student më 1972, është një prej momenteve ma të rëndësishme që e kujtoj me kënaqësinë ma të madhe në jetën teme [shfaqë një ndjenjë gëzimi dhe hareje në sytë e tij përderisa flet për këtë periudhë]. Isha anëtar i Lidhjes së Kryesisë së Studentëve në Fakultetin Juridik edhe u organizun atëherë protokoli me Universitetin e Tiranës edhe Universitetin e Prishtinës për këmbim të kuadrave dhe vizita të ndërsjella të studentëve. I propozuam kush me shku prej Fakultetit Juridik, e normal, unë nuk isha në radhë me shku hiq. E propozuam këtë Mazllum Bajraliun që tash është profesor, ka qenë edhe kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, po nuk ia dhan pëlqimin partia.

Edmond Sylja: Për çfarë arsye?

Mexhid Sylja: Nuk kanë tregu arsyet, mirëpo është shumë diskutabile puna e tij. Na atëherë e kemi ditë si shqiptar shumë të madh, ma vonë ka pas deviju krejt diçka. Ishte aty si grup i Suharekës shumë, edhe u kanë një Muhamet Kadolli, e propozuan atë, edhe atij s’ia dhanë. Thash, “More cimë pse?”, se me Mazllumin kemi qenë cimer një vjet, domethonë dhomën e përbashkët, e ja dhosha Osmanit me shfrytëzu verës, e dimrit shkojsha unë, se verës nuk kisha kohë.

Tha, “Po more, cimë, veç a bohet, provo qysh jo, po duhet me bisedu me Ragip Aliun, se është sekretar i organizatës së Lidhjes së Komunistëve për Rektorat”. Edhe çohna, shkoj unë te Ragipi, thash, “Daj, qeshtu, qeshtu, qeshtu...” [duke tregu se si ka rrjedh ngjarja]. Tha, “A ta kanë dhënë pëlqimin këta, kryesia jote?” Thash, “Po.” Tha, “Shko bima pëlqimin menihere.” Edhe shkova, ma dhanë pëlqimin ata që jam i propozuem, edhe ma dha ai aprovimin, që s’ka problem.

Edhe tash, “Ndodhi rasti i njëjtë si me diplomë, ku nuk kisha pasaportë.” Haaajjj, nanën ja kajsha... [një zë i lehtë, duke humbur në mes të fjalëve]. Ishte afati shumë i shkurtë, edhe i mbledha dokumentat, e thirra një Ramadan Ferizi, qetu u kanë i Bollopojës, që punojke në pasaporta. I thashë, “Qeshtu, qeshtu, Ramadan,” e më tha, “Mexhid, po, kqyri veç, vallahi, bash sot për nesër nuk ka shansë me kry atë punë.” Edhe e dorëzova, e i çunë pasaportat në Beograd, në ambasadë të Tiranës, me marrë vizë.

Salihu është ende gjallë, edhe me respekt i përkulem e i thom që nuk të harroj sa të jem gjallë. Tha, “Mexhid, mos u bo marak,” se atë ditë që shkoj me i marrë këto, nëse e rregullon pasaportën tane, unë e marr me veti edhe kanë me ma dhanë edhe vizën tane. Edhe unë nuk besojsha, se jo veç unë, po krejt shokët, Nazmi Ejupi, Qaza e Osmani e Bajrami, me padurim e pritshin, a është e mundun me shku në Shqipni në ‘72, heejjj... I kom dorëzu, edhe ka shku atë ditë që erdh. Njeri i madh kur don me qenë, se është humanist e i kujdesshëm, se e ka qaty, e nuk del me lajmëru, e si u dalë në derë me na lyp, mas pari më ka lyp mu me sy, me m’dhonë shenjë që është okej edhe u kry puna.

Më kanë përqafu edhe mu kanë gjujtë krejt, se edhe sot krejt trupi m’rënqethet... mu kanë gju urime, urime, urime [tregon dhe shfaq emocione mbi atë periudhë dhe ndjesinë që kishte, duke bërë lëvizje me duar], edhe kemi hyp autobusit e kemi vazhdu për atje ku kemi nejt 16 ditë.

Edmond Sylja: Si e përjetove krejt këtë udhëtim për në Shqipërinë e asaj kohe?

Mexhid Sylja: Krejt e kemi pa idealin se çka është ma së miri, se ishim të indoktrinim ashtu. Na informatat për Shqipni dhe lajmet për Shqipni i kemi marrë nëpërmes Radio Kukësit, se ka pas frekuencë më të lartë se ajo e Tiranës, edhe s’kemi pas probleme në Kosovë, kudo që kemi shku me dëgju radion, ku ka pas këngë folklorike, po edhe lajme dhe kumtesa më të rëndësishme. Krejt e pajshim ideale, mirëpo ka qenë një vend i mjerum, një gjendje katastrofike. Edhe unë aty jom njoftë me motrën e Jonuzit, Kaden, ku 40 vjet pa pa kërkon ajo hiç. [tonacioni i zërit filloi të ndryshojë duke u përshtatur sikurse koha që ishte në Shqipëri, disi e ngrysur].

Edmond Sylja: Qysh ka përfundu ajo atje, ishte ndonjë martesë apo diçka tjetër?

Mexhid Sylja: Baba i Jonuzit ka shitë tokën në fshat dhe u nis me shku për në Turqi. Ka shku në Shqipni, po atje s’ka mujt me nejt, nuk e di për çfarë arsye, e çikën, domethonë motrën e Jonuzit, e kish martu për një person që ka qenë aty, edhe ia ka dhonë atë fëmijë diku rreth moshës 14-15 vjeçare edhe kurrë pa e pa kërkush ma. E kom shku, si kom mrri në Tiranë, bleva kuptohet do sene prej kahit i mora, se e disha që pa e taku nuk e la. I kom shkru, “Jam Mexhid Sylja, kushëri i Jonuzit, jam i vendosun në Hotel Peza, Tiranë, ejani të njoftohemi”.

Edhe jon ardhë. Tani të nesërmen kanë ardhë, jemi pa, jemi njoftu e sene, edhe po i thom, “Hajde po hym në hotel Dajti.”

[një pauzë e shkurtër që i paraprin përgjigjes] “Jo mik, jo, që po ulem qetu ka qendra, do kafiteri,” atëherë ju thojshin pastiçeri, edhe aty kishin pi raki. Çfarë gjendje, çfarë mjerimi e faqe e zezë... I thashë, “Jo more, ku me hi këtu?” {tregon me fytyrë shenja të pakënaqësisë} Tha, “Jo, hajde po hym këtu.” Edhe hym. Kur dolem me u nda, ai Hashimi nuk guxojke me folë në prezencë të gruas së vet, e djalit s’di a e ka pas me vete a s’e ka pas.

Tek kur kom shku e kom pa, kur kem shku në Kavajë ka kalojmë me shku për Fier, e jom nalë aty, ia kom dhonë qato sene edhe sahatin tem djalit të asaj Kades. E tha, “Mos na thuj me hi aty se e kemi të ndalume,” [me një zë të lehtë e thotë, sikur të ishte duke e përsëritur në atë kohë që të mos e dëgjonte askush] edhe çka më ka thanë ashtu msheftë, një peshqir të madh e pata ble përveç tjerave. “Faleminderit,” tha, “për qeta peshqir, se falna me to në vend të sexhades.” Sa i përket atij idealizmit tonë, unë me i vizitu ato monumente e me i fotografu, ku kish fotografi të Enver Hoxhës, e mora literaturën marksiste-leniniste, të Mao Ce Dunit, anena e knena, na i morën në kufi krejt. Po, po thom, përkundër sfidave, atë moment e atë kënaqësi nuk e harroj kurrë, nuk e harroj.

Edmond Sylja: Cili ka qenë qëllimi i vizitës?

Mexhid Sylja: Qëllimi i vizitës ka qenë vetëm këmbim i përvojave. Na kanë pritë në dy-tri fakultete, varësisht në cilin ishim, se në mesin tonë ka pasë serb edhe boshnjak, se ashtu ish struktura e studentëve në fakultetin tonë. Edhe qashtu ka qenë marrëveshja. E mandej fillun profesorat e Shqipnisë me ligjërë këtu, e sidomos fakulteti teknik ka dhonë kontributin ma të madh në ngritjen e kuadrove tona. Kanë ardhë me vite të tana kanë ardhë... [një pauzë e gjatë, duke përmbledhur mendimet dhe kujtimet e asaj kohe]

Çka me thanë tjetër, se është temë e gjanë me folë për çka ka pasë në Shqipni, po është kënaqësi dhe dinjitet i veçantë. E kujtoj atë moment, e atë çka kemi pa atje, kur kemi ardhë këtu e kemi analizu se qysh ke mirë, e rrejsha sa mirë, e kur u krijun kushtet me shku, më thojshin, “U të marroftë Zoti, qysh na ka rrejt ashtu!” [bëhet fjalë për kohën e komunizmit në Shqipëri dhe vështirësitë për mbijetesë]

Edmond Sylja: Për çfarë arsye ke gënjy për idealin shqiptar?

Mexhid Sylja: Po, u munojsha me livdu edhe me mbrojtë një farë idealizmi që mbizotëronte gjithë te na, që Shqipnia është Shqipni, Shqipnia është armatosun e munet me bo gjithçka, e Shqipnia i ka krejt të mirat, e nuk guxon me vjedhë kush. Jon të barabartë, krejt qato gjana që i predikojshin ata, i marrshim qashtu si ishin, masi nuk kishim mundësi me i pa. [e thotë me një bindje sikur gjitha këto të ishin të vërteta]

Pjesa e katërt

Edmond Sylja: Tash, në aspektin profesional, si ndodhi që nga gjykata me vazhdu karrierën tutje?

Mexhid Sylja: E po, në Podujevë derisa kom qenë, mu mu është nda një banesë edhe nuk kom shku në atë banesë se isha i interesum me i ndihmu familjes, se e kisha Nexhatin sa më kish lind [djali i tij i madh], as që m'ka shku mendja me shku në banesë e me i lanë prindt. Kom ardhë këtu e kom jetu, edhe ka qenë pjesa ma e mirë e jetës kjo, në Shqipni edhe kjo, se mas pari isha i ri edhe arrita me diplomu, edhe e dyta, në aspektin material, kisha një mirëqenie. Në gjykatë ku punojsha ishim pjesa dërmuese shqiptarë, ose ishte një gjyqtar serb, ose një, eventualisht, ma shumë nuk kishim. Në administratë veçse filloi me u përmirësu gjendja, në komunë veç filloi edhe... kemi qenë regjistrimi '81, unë kom qenë zëvendëskryetar i komisionit për regjistrim të popullsisë në komunë të Prishtinës edhe i di të dhënat mirë.

Komuna e Podujevës në regjistrimin e '81 ka pasë ma pak serbë se komuna e Gjakovës. Ramush Rama ka lujtë një rol shumë të madh kur ka ardhë kryetar i komunës së Prishtinës edhe ndodhën qeto ndryshime në kushtet e atona. Mirëpo, varet prej personit sa i shtyn gjanat përpara, sa i shfrytëzon ato mundësi që ja jep ligji, e Ramushi ka qenë ndër ata që i ka shfrytëzu. Edhe e përmenda punën e banesës si shkas për çka vendosa me ikë, ka qenë, ndër të tjera, edhe banesa. Edhe mu veç fillun me m'marr për në sy të keq disa ish-komunista, një Jetullah Gashi, që çdo mandat na e çojshin kryetar komune në Podujevë, e ni Nezir Gashi. Edhe i ika shërbimit ushtarak, edhe shkova në Nish, nejta nja tri javë në spital, e rregullova. Ndhimoi njëfarë Shabani qetu i Sekiraqës.

Edhe atë e kisha unë problem, se mos me pas ushtrinë e kryme, për me qenë në pozita ma të nalta si gjykatës apo diku, ish problem. Po në Prishtinë ato sene nuk u kqyrshin, se në Prishtinë ish një qendër ma e madhe. Edhe erdhi puna rreth qasaj banese, ja dhashë një dajës tem, Hizrisë, se unë nuk isha duke e shfrytëzu, e ai hyri me familje. Kryetar i komunës ishte njëfarë Nezir Gashi, edhe s'kom ditë kurgjo me thanë. "More, po thotë dikush që kanë vendos me e qitë Hizrin prej banese, me ta marrë banesën krejt." E shkova, u përlava me kryetarin, e s'lashë gjë pa i thanë. Edhe e pashë që u prish veni aty, e tash, "Don me bo çdo gjë që me m'largu prej partie," se ma së pari të largojshin prej partie, e mandej edhe të largojshin prej pozite. Edhe vendosa me u tërheqë e me shku në Prishtinë.

Kom konkuru në Prishtinë, edhe më kanë pranë në shtator të vitit 1975. Jom kanë në Ulqin se pata ikë e lëshova Podujevën edhe konkurova këtu, edhe pata dëgju në radio që Kuvendi Komunal i Prishtinës zgjodhi gjyqtarin Mexhid Sylja gjykatës në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Jom kthy, ja kom fillu punës, edhe aty u kanë një kënaqësi e veçantë, se ishim një kolektiv shumë i mirë. Të ardhurat personale i kemi pasë ma mirë se në Gjykatë të Qarkut, se atëherë gjykatat jon financu prej komunës. Komuna e Prishtinës ish komunë e fortë ekonomikisht, e ka pasë atëherë Fushë Kosovën e Obiliqin, Graçanicën mo mos të flasim, u kanë një ndër komunat më të mëdha në Jugosllavi. Mense në Jugosllavi mos të flasim, se me Beograd e me këto nuk u krahasu, po u kanë komunë e fortë ekonomikisht edhe si qendër administrative.

Edhe punojshim, një kënaqësi e veçantë edhe aty. Ku kom punu, të merremi vesh, kom qenë shumë i suksesshëm edhe kurrë nuk ka ndodh mos me e plotësu normën që është kërku, po edhe kom qenë shembull në aspektin profesional e njerëzor, me komunikim e krejt. [Një pauzë nga e cila fillon tregimin e tranzicionit në pozitë.] Një ditë po më thërret sekretarësja e kryetarit të gjykatës, serbe ishte. “Flet në serbisht duke treguar se po ju thërret,” tha kryetari i Gjykatës Supreme. U kanë një Riza Fazliu, u kanë një profesionist i madh, por nuk e kemi pasë në sy për të mirë, se u kanë i martum me një serbe edhe kishim një bindje se nuk është bash shqiptar i mirë. Amo meqenëse punët i kryente qysh duhet edhe ishte profesionist i mirë, na e kemi pasë gabim. Tash, kur jemi ma real në vlerësim, e kemi pasë gabim.

Edhe shkova, “Mirëdita”, “Mirëdita,” thash, “kryetar, më kishi thirrë.” Tha, “Po,” tha, “të kom thirrë me shku në komision për çështje ekonomike, me bo kërkesë për gjykatës të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.” U preva, me të thanë të drejtën, se nuk m’shkojke hiç, hiç, s’mu shkojke. [E zgjat fjalën “hiç” duke treguar sa i pakënaqur ishte.]

Edmond Sylja: Për çfarë arsye?

Mexhid Sylja: S’mu shkojke, se veç sa fillova këtu, po e kisha kolektivin e mirë, të ardhurat e mira. Me të thanë të drejtën, edhe na kemi pasë marre... atëherë e kemi pas frikë bre prej punës, bre. Nuk isha i përgatitur me punu në Gjykatë të Qarkut.

Frigohesha që nuk mund i dalë Zot, edhe pse e disha veten që normal, duhet angazhim më i madh, se edhe kryetar... Thash, “Unë nuk e di, thashë unë... Ju e dini kom punu në Podujevë tri vjet,” thashë, “po Podujevë do lëndë të lehta, do vjedhje të pyllit, do vjedhje të lehta, do sene... Si lëndë të kriminalitetit ekonomik nuk kom pas, e aty në Prishtinë pak ma ndryshe, lëndë ma serioze,” e thashë, “po frigohem që s’jam i përgatitun.” “Djali i mirë,” tha, “a je i përgatitun a s’je i përgatitun, na e kemi vlerësu prej lëndëve tua. Ose qaty ku po të thom, ose as qaty, as këtu ku je”, edhe qeqaq ka pasë.

Edhe normal, s’kisha çka me thanë, “Jo s’po shkoj”, e me mbetë tash hajde me kqyrë konkurse anena e knej, e me dalë në gazeta, e me refuzu pozitën... Megjithëse gazetatat atëherë nuk jonë kanë, për faqe të zezë, sikur këto tash, me u marrë me gjithfarë pune... po kanë mujt me e bo atë punë. Edhe shkova, e bona kërkesën, edhe u zgjodha gjykatës i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, edhe kom punu nja afër një viti.

Edmond Sylja: Qysh e përjetove këtë tranzicion edhe pritshmëritë që i pate?

Mexhid Sylja: Normal, me një ngarkesë të madhe për shkak të përgjegjësive që ishin... Me punu në Gjykatë të Qarkut u desht me ju rrek punës, por nuk kom qenë i kompleksum asnjëherë për vete. Me njerëz që kanë përvojë ma shumë, me marrë mendim prej tjerëve... Edhe tash i kom thanë edhe Avnis, “Mos hezito asnjëherë nga balin Mexhid, mos hezito, se nuk ligësuhesh nese e pytë një koleg. Merrja

mendimin, ti prapë vendos vet, po merrja vendimin profesionalisht, çka po mendon për një çështje, se ki gjithfarë rastesh në gjykatë.”

Edhe shkova, ja nisa si gjykatës hetues, *bam* ni rast, *bam* ni rast, *bam* ni rast... [e përsërit disa herë duke lënë të kuptohet numri i madh i rasteve që kishte trajtuar]. Një ditë, kur ishim kujdestar si gjykatës hetues, u deshtë me nejt në shtëpi. Unë banesë në Prishtinë nuk kisha, edhe isha në odë. Një sirenë, *ty-ty* {onomatope}... edhe unë dola, e çita kryet. Kur po e shoh, kerri i gjykatës. Doli një serb, po thotë, “*Šta, Fiqo?*” (Çka, Fiqo?), tha, “ka një vrasje në Podujevë,” tha. “Erdha me të marrë.” Edhe u çova menihere, u bona gati me dalë. Kom shku në Podujevë. Derisa u kompletu ekipi i forenzikës, u vonu goxha shumë. Edhe kemi shku në Pollatë. Kur kemi shku atje: shi, natë, terr... [e thotë me ngritje të tonit, duke theksuar çdo fjalë, “shi, natë, terr”].

Po kqyri kur po shoh që kryetari i gjykatës, Luba Pupoviça, që prokurori njëfarë Pjetër Kola u kanë, çka po lypni ju këtu, tha, “Po, kur nuk është gjykatësi edhe prokurori, duhet me dalë kryetari i gjykatës edhe kryeprokurori.” Thashë, “Nëse mendon mu, e ki gabim,” thashë, “e kom dëshmitar shoferin që në shpi jom kanë, jom nisë, menjëherë kom dalë, jemi vonu në Podujevë pak,” thashë, “s’kemi pasë çka me bo”, edhe prapë po kthehna te ajo që thashë, të priftë e mos i prifsh. Intuita është shumë send me rëndësi, se pata një ndjenjë se është rast i komplikuar, se kishin vra, kish vdekë një serb, edhe me kry vendshiqim atë natë, në ato kushte, nëpër shi, nëpër terr, veç me do llampa që i bojshin qeshtu {tregon me duar}, ndodhë ndonjë lëshim e sene edhe muna me ja pa sherrin.

Unë e thirra komandirin e policisë, u kanë një Shefqet Vokrri, thashë, “Shefqet, unë vendshiqim sonte nuk mundem me e kry në këto kushte.” Kcej Kryetari, tha, “*Kako, Mexhid, ne mora.*” (Hajt, Mexhid, nuk ka nevojë.) Thashë, “Unë *ne mora* (nuk kom nevojë), ai që mendon që duhet me u kry sonte, le të urdhërojë të kryhet në çdo kusht, unë nuk e kryj, nesër në ora 8:30 e caktoj vendshiqimin edhe dalim në vendin e ngjarjes.” Edhe metën, nuk guxuan me lëvizë asnjë.

E kom kry vendshiqimin, u burgosën baba me djalë me propozim të prokurorisë, iu caktova paraburgim, edhe djali thojke, “Unë i kom ra, jemi ardhë prej malit, i kemi lëshu loptë prej zgjedhe, prej kerrit, edhe e kemi lanë kerrin në oborr edhe kemi dalë në pemishte. U dalë,” tha, “ai ja ka nisë me sha e me bërtitë shkau,” tha, “edhe i kom marrë loptë,” tha, “po m’u dokë që shkoi me marrë diçka. Çka ka pasë që nuk është me rëndësi,” tha, “jom hi e e kom marrë revolen,” tha, “edhe e kom gjujtë prej qetuhit dy herë, e di që s’e kom rrokë. Jom aftu qetu ku u kanë një mur te dyrtë sikur te Avnia që i ka tash, edhe u kanë një avlli.” Avlli është gardh ma i madh. Avllisë i kanë thanë një gardh ma i madh, “edhe e kom zënë pozitën, distanca prej murit deri te huji u kanë një gjysë metre. E kom marrë edhe e kom gju, edhe e kom ni që ka bo jo.”

Ata shkijet dojshin me ja lanë babës, nejse, babën u deshke me majtë në burg një herë derisa të kryhen hetimet e sene. E krevja landën, po thërret Kryetari, tha. “Duhet me dalë në rikonstruim në vendin e ngjarjes, masi e dorëzova në prokurori, se qashtu u kanë procedura. Se qashtu u kanë procedura, i

kryjke hetimet gjyqtari, e qojke në prokurori, prokuroria aktakuzën edhe tani i kthehet gjykatës në gjykim.

Shkova te kryetari, më thirri në të vërtetë. “Mexhid,” tha, “duhet me marrë këtë lëndë e me bo rikonstruktimin në vend të ngjarjes. Përveç teje, ka me qenë,” tha, “edhe një gjyqtar serb, prokurori ka me qenë, përveç Halil Kelmendit, ka me qenë edhe një serb, mjeku i mjekësisë ligjore, përveç Fadil Batallit, ka me qenë edhe një serb, eksperti i balistikës, edhe një serb, edhe ka me i përcjellë kamera e Suki-t me inxhiru vendshiqimin krejt.”

“Kqyre,” thash, “unë nuk kom ni që në fazën e hetimeve bohet rikonstruktim i vendit të ngjarjes, edhe nuk dal,” thash, “nëse keni naj arsye që kom lan diçka,” thash, “ma mirë me m’than plotëso edhe qeta se me bo rikonstruktimin në vend të ngjarjes jo.” “Jo,” tha, “duhet.” Unë po të thom, nuk e boj” [e thotë me një neveri, sikur po i drejtohet kryetarit të gjykatës në atë moment], “edhe e refuzova kategorik.”

Shkova te Fazli Bala, po bisedoja me to, qeshtu, qeshtu, qeshtu. “Po, s’e di,” tha “Mexhid, mos je ngut pak?” Thash, “nashta jom ngut, po unë po mendoj qashtu edhe s’e besoj.” Edhe Shefqet Bytyçi u kanë zëvendës i kryetarit, ai ish prezent kur bisedum, kurrë s’e qeli gojën. U kanë burrë i ligë” [shfaqë zemërimin që kishte me të, duke theksu dhe ngritë zërin]. Tha, “Mexhid, u gute pak,” ja nisi me i fërku duart, e ka pas një farë stili {fillon t’i fërkojë duart, ashtu duke imituar atë}. Tha, “Mexhid, u gute pak se duhet me kry atë punë, se politika ka ndërhy.” Tha, “Ivan Stapoviçi u kanë kryetari i Komitetit Qendror të Serbisë!”

E ka thirrë Mahmut Bakallin, kryetar i komitetit tonë, edhe i ka thonë, “A po doni me i vra krejt serbt a çka u bo, se mrena tri mujë ditë, tri serbë të vramë në mënyrë të ngjashme sikur kjo, edhe ka marrë përmasa të mëdha.” “Po pse s’kallxove, Shefqet, sa kem aty,” i thash. Nejse, e mora lëndën, e tash domethënia e krymjes së punës me kujdes edhe me profesionalizëm, ose që ndërlihet me atë që thashë, të priftë e mos i prifshë, në fazën e hetimeve. Një ditë më erdhën përgjegjësit për ndërlikte të gjakut, pra, nga sekretariati i Punëve të Brendshme, me një ekspert të forenzikës.

Tha, “Gjykatës kemi vendos,” tha, “me dalë me kqyrë edhe një herë për atë gëzhhojën e tretë.” Se dy gëzhhoja i gjeta, ky tha djali që kom gju dy herë, ku thojke herën e tretë që kom gju, nuk mujtem me gjetë. Ajo ishte prova kryesore që e vendoske fatin edhe e vendosi. Thash, “Okej,” thash, “unë du me ardhë.” Shkova te kryeprokurori Kelmendi, i thash, “Me ardhë.” Tha, “Jo, nuk kom pse vi se unë e kom të kuartë se kush e ka vra.” “More hajde,” thash, “të kuartë,” thash, “ky është veprim hetimor që është me rëndësi.” Tha, “Jo,” tha, “nuk kom nevojë.” Edhe u çum, shkum.

Si kemi shku me atë Smakiqin, me përgjegjësin e delikteve të gjakut, thash, “Hajde të shkojmë t’i shprehim ngushëllime,” ishin hala ka vajtojnë te familjes. Edhe na ka thirrë Jusuf Gjevukaj, u kanë ky i forenzikës, “Smajo, Smajo, Smajo,” tha, “gjykatës, gjykatës, gjykatës, ejani, ejani,” tha. Kur shkum, tha,

“Për Zotin, e gjeta gëzhojën,” edhe u gjet ajo gëzhojë. Edhe e bona një procesverbal plotësues mbi vendshiqimin, edhe qajo gëzhojë e vendosi fatin e rastit. Baba u lirua i pafajshëm; një herë u dënua me pushkatim, e u shndërru në njëzet vjet, e shkoi lënda në Zagreb sipas ankesës. Bajram Kelmendi u anku, edhe Zagrebi tha, “Veç qetu ka mujtë, ku,” tha, “djali që ka gju, në herën e tretë, ku u gjet kjo gëzhojë, prej kësaj pozite me u vra,” edhe u kry ajo punë.

Aty tani u ftofta, se u kriju një ndjenjë e keqe, se nëse vazhdojnë kështu... Edhe fola me Bajram Tmavën, thash, “Bajram, do me lëshu gjykatën.” Tha, “Pse more? Ti veç sa shkove.” “Valla, Bajram,” thash, “qeshtu, qeshtu.” E pata një farë rasti edhe jom ftoftë. Thash, “Nuk rri mo.” Më tha, “A po vjen në Komunë të Prishtinës?” “E çka me bo aty?” Tha, “Sekretar i Këshillit Ekzekutiv.” Pozita e sekretarit të Këshillit Ekzekutiv ishte pozita e katërt në hierarki në Komunë të Prishtinës: kryetari i komunës, kryetari i Këshillit Ekzekutiv, kryetari i Kuvendit, sekretari i Këshillit Ekzekutiv, edhe tani ishin drejtorët e drejtorive. Thash, “Po, more.” Ai tha, “Veç mos gabo,” tha, “me ardhë,” tha, “me bisedu pa e lëshu vendimin për banesë.” Edhe shkum te Nazmi Mustafa, ka qenë kryetar i komunës, u kry ajo punë. Tha, “Po, Mexhid,” tha, “edhe për banesë vendim menjëherë po ta lëshojmë.”

Edmond Sylja: Për cilin vit po bëhet fjalë?

Mexhid Sylja: Ka qenë ‘79, 1979. Shkova në komunë, ja nisa, punova një kohë si sekretar i Këshillit Ekzekutiv, mandej sekretar i Kuvendit, edhe prej sekretarit të Kuvendit, jo që kom lypë unë, po kanë propozu vetë strukturat atëherë që vendosnin për çështje, me shku për sekretar për Urbanizëm me përmirësu gjendjen, dhe ishte ndër sekretariatet kryesore. Edhe aty kom refuzu edhe kom thanë, “Jo, Mustaf,” se Muhamet Mustafa u kanë kryetar i Lidhjes Socialiste, i thashë, “Muhamet, jom jurist unë, çka kom me lypë aty?” “Mexhid,” tha, “na e dimë që ti mundesh me bo diçka, se aty katunarët nuk po kanë pse afrohen edhe po ka probleme në atë drejtorat, edhe duhet me shku gjithqysh.”

Kom shku, me të thanë të drejtën, edhe e kom rregullu, që u kanë shembull ai drejtorat. Edhe aty, sipas inercionit të pozitës, kom qenë kryetar i Këshillit për Urbanizëm, kryetar për ndamje të banesave, s’di, i kom pas do pozita, edhe kom punu në Komunë të Prishtinës gjashtë vjet.

Edmond Sylja: Qysh ke kjo periudhë prej sistemit gjyqësor në Komunë të Prishtinës?

Mexhid Sylja: Po, jom gjindë, pa problem jom gjindë. Edhe të thom të drejtën, jo veç që kom kalu mirë vetë, po edhe sot për ata punëtorë që jonë, në emër tem hala flitet emri i Mexhid Sylës për korrektësi dhe profesionalizëm. Edhe atë e kom dëshmu edhe mas luftës, që do të vijmë edhe te ajo pjesë. E prej aty kom shku në klub të Prishtinës, se u prisha me kryetarin e komunës, një farë... [kujtohet për emrin e tij], se nuk u pajtoheshim me to në shumë sene. Po aty nuk shkova haku i tina, po se isha anëtar i Kryesisë së klubit Prishtina. Qekjo gjeneratë e artë që po përmendet tash, atëherë u kanë ajo punë. Në ‘83 shkova si anëtar i Kryesisë.

Dhash një kontribut të jashtëzakonshëm, kuptohet me anëtarë tjerë të Kryesisë, edhe mrritëm me hi në Ligën e Parë të Futbollit të Jugosllavisë. Ka qenë një atmosferë me atë klub që nuk mundet me u përshkru. Deri në 40.000 vetë në stadium të Prishtinës kanë hy atëherë për me ardhë me kqyrë Prishtinën, prej Preshevës e deri në... çka jonë kanë këto, Tetovë e faqe të zeza, e anena e knena. Edhe më thirri Azem Vllasi, tha, “Mexhid,” tha, “duhesh me shku në klub, se e kemi vlerësu që duhet me shku në klub me ndihmu për me mbetë në ligë.” Thashë, “Azem, nuk shkoj, se nuk e keni për klub,” thashë, “po doni me m’hjek prej komune për shkak të raporteve me kryetarin e komunës.”

Azemin nuk e kom dashtë as atëherë, edhe e kom pas bindjen që nuk është burrë i mirë, nuk është shqiptar i mirë, edhe s’deshta me ni atë punë. Edhe më ka thirrë Nebih Gashi, ka qenë anëtar i Kryesisë së Kosovës. “Mexhid,” tha, “qeshtu, qeshtu,” tha, “a po e sheh që ma shumë po ndikon qaj klub në politikë, në stabilizim të gjendjes politike, sesa na krejt çka jemi prej strukturës, parti e drejt çka jemi, anena e knena.” “O bacë Nebih,” i thashë, “vallahi, më fal,” thashë, “Azemit i kom thanë; ty nuk po muna me të thanë, se po frigohem që e keni për shkak të raporteve me Tomen. Tomen i kom thanë, nëse ki ti diçka, hajde dalim në Kuvend, ti qiti argumentet e tua, e unë po i qes të miat, e le të vendosë Kuvendi. Ti nuk mundesh me m’shkarku mu, je kryetar sa të duash.”

Tha, “Mexhid,” tha, “nuk është,” tha, “besom, po ta jap fjalën që nuk është,” tha, “shko, edhe mas një viti veç të mbesim në ligë sivjet,” tha, “hajde te unë ku të kesh qef, vallahi po du me shku, qetu ki me shku.” Masanej, as s’i kom shku kurrë diku deri sot, përveç dajës tem për Gjykatë Komunale, me shku me ja fillu punës, se për me shku në pozitë ma të naltë, as s’i kom thanë kujt, po gjithmonë më ka propozu dikush, as mos prit që të thom. Pra, po ta jap fjalën që kom me shku. E kom kry me shumë sukses edhe atë punë.

Edmond Sylja: Çfarë pozite në klub të Prishtinës?

Mexhid Sylja: Drejtor i klubit, drejtor i klubit. Edhe e kemi kry, e kemi përfundu në vend të tetë, a kemi mujt me përfundu në vend të katërt edhe me dalë menjëherë në Kupë të Europës, si katërshja ma e mirë në Jugosllavi. Po na i bonë do dollovere vetë mrena Kryesisë, e tash me hi te ato dollovere jonë punë të tepërta që s’ka nevojë. Tani edhe aty u ftofta me kryetarin e klubit që ishte atëherë një Mehmet Maliqi, edhe për shkak që na e boni qet dollover. Se ishte kënaqësi për mu me thanë që po del në Europë, lojtarët i kishin do premia të mira, për trajnerin ish shumë me rëndësi, mirëpo u lujt një lojë shumë e ndytë.

Edmond Sylja: Kjo ke Kryesia..?

Mexhid Sylja: Kryesia, Kryesia, pikërisht Kryesia e boni një dollover, diçka.

Edmond Sylja: Për çfarë arsye ndodhi kjo?

Mexhid Sylja: Ajo ndodhi që mos me iu dhanë lojtarëve premia, po edhe ndoshta kanë pasë ndonjë interes tjetër, diçka... ku ta di unë. Tash mundem veç me supozu, për me shku dikush te ndonjë klub, po nuk e di arsyen tamam pse e bon atë faqe të zezë. Po kryesorja, u kanë shumë gjest i keq. E qashtu, mandej, prej aty kom shku në Autotransport, drejtor.

Edmond Sylja: Para se me fillu aty, qysh ke kjo përvojë në klub të Prishtinës, ndoshta diçka që don me veçu aty?

Mexhid Sylja: Uuu, aty, aty, aty...

Edmond Sylja: Pasi që u quajt periudha e artë, çka e ka karakterizu këtë?

Mexhid Sylja: Ajo periudha e artë u karakterizu me një ekip që e bëm shumë solid, një Kryesi shumë homogjene dhe kemi funksionu si një trup: shtabi teknik, lojtarë dhe Kryesia. Ashtu jemi koordinu, por e kemi pas përkrahjen e strukturave të atëhershme politike, edhe në komunë. Edhe në atë anë isha në Urbanizëm dhe i disha ku ka ndonjë lokal ose banesë që mundet me u siguru me kushte të mira, edhe ju propozojsha në Kryesi, e përfllishim procedurën dhe e dërgojshim kërkesën në Këshill Ekzekutiv. Edhe krejt lojtarëve çka jonë kanë këtu shqiptarë, ju kemi dhënë banesa, lokale... edhe normalisht sukseset kanë qenë të jashtëzakonshme. Edhe ka qenë një periudhë shumë interesante, me pa tonë atë publikë e tonë atë... u kanë diçka e paimagjinueshme për rrethanat tona.

Kishim pengesa shumë të mëdha, se qysh një klub shqiptar i Kosovës me lujtë këtë rol, me mujtë Crvena Zvezdën e Beogradit në mes të Beogradit tri herë. Kryetari i Kuvendit të Jugosllavisë, Dragosllav Markoviq, ka qenë, ka e kqyrë lojën, edhe u çu, e ka lonë, veç ka sha, e ka gjujtë, edhe u ikë, kanë dalë jashtë. Kemi pas raporte shumë të mira me klube, për shembull me klubin e Hajdukut të Splitit. Kemi qenë delegacioni i parë që na kanë pranë, që na kanë pritë me një restorant në atë kohë, edhe çfarë pritje kanë qenë! Ku kemi shku, kemi lënë përshtypje, po, mrekullina të Zotit. Ka qenë një ndjenjë që kemi mri suksese, edhe po e shohim edhe tash: sporti, çka do me thonë me qenë një klub i fortë e me qenë i suksesshëm.

Edhe u tërhoqa, qashtu kadale shkova mandej në Elektroekonominë e Kosovës. E tash, sa i përket te klubi kur jemi, vlen me përmend si rast se, në ndërkohë, pas kësaj pabesie që ndodhi në vitin e parë, na e kemi pas një trajner të Sarajevës. Edhe u kanë një burrë shumë i mirë dhe i pranuem për mjediset tona, edhe shqiptarët e atijë ja morën pak inati, se rrike veç me shqiptarë, edhe ja vnojshim ndonjëherë një plis të bardhë, edhe ajo u pengojke për atë kohë. Edhe atë nuk e zgjodhën, po e prunë një tjetër. Ai arriti sukses, edhe po e ndrron tash trajnerin. Edhe ai ka qenë shkaku kryesor që unë më nuk dojsa me ni, edhe ajo pabesi, nuk dojsa mo me nejt si drejtor i klubit, po anëtar i Kryesisë isha. Edhe e prunë atë, po u pështoll puna me të, e filloi klubi me marrë teposhtën. Edhe erdh deri te një situatë: ndrron një trajner, ndrron një tjetër, s'po mundet me bo kurgjo. E thom, "More, a bon me

bisedu me Ćiro BlaŹević-in?” Njē nacionalist kroat, njē trajner me renome në Jugosllavi, ndër më të mirët.

Morēm vendim në Kryesi me shku te ai. Kush me shku? Duhet me shku Mexhidi, si drejtor i klubit, në fakt, si anëtar i Kryesisë, se Berisha pati ardhë si drejtor. Edhe shkum në Qirit, bisedum anena-knena: “Jo, s’muj,” “Jo, duhet me ndreq këto e ato,” “Jo, duhesh me ardhë,” “Jo, s’bon pa ardhë,” “Jo, kom me i ndreq dhëmbtë, 22 mijë marka jom ka i paguj.” I thashë, “Ooo, lehtë është ajo punë, ooo Ćiro, *kako?* Qysh?” i thashë.

“Shkojmë na nesër për Kosovë, i kemi lojtarët në Studenicë në përgatitje, caktojmë një konferencë për media, e merr vesh krejt Jugosllavia që Qiro BlaŹeviqi erdhi në Prishtinë, edhe situata krejt ndërron, bëhet për të mirë. Edhe ti pastaj kthehu e ndreqi dhëmbët, se na i kemi do trajnerë që munden me vazhdu punën. Jepja detyrën, le ta dinë lojtarët që e kanë trajner Qiro BlaŹeviqin.” “Ohhh,” tha, “po nuk e ki keq.”

E tash u nisëm për me marrë biletën për to në agjension. Kur shkum, na i qitëm edhe biletat tona, edhe po thojnë nuk e di, u bo diku 4000 franga krejt. Edhe na kishim llogarit vetëm sa për të. Unë i kisha marrë 1800 franga të mitë, ai Xhevati, tybe, nuk e kish pas as një. Përveç biletës së tij, u dashtë me pagu një shtesë, se nuk rrijshim një javë ditë, po u desht me u kthye menjëherë, edhe u dashtë me pagu një shtesë. Edhe meta unë. Ai më hetoi, e tha, “Shtaje,” se e ka pas një shprehje, “çka djali jem!” Thashë: “Nishtja, nishtja.” Tha, “Në nishtaje?” Ja nisa po qesha, thash, “Qyshtu, s’po kemi pare me ta pagu biletën.” Edhe te madhe aty, edhe ke kogja kallabllak, si e panë atë, e tha, “*P***a vë mater!*” Një shamje, “Në rrotë të sames shkoni! Jeni ardhë për Qiro Bllasheviqin e nuk keni pare me ja pagu biletën për aeroplan!” Edhe i nxori 4000 a 5000 franga, se tha, “Ju duhen për vete, me ble dhuratë a diçka.” Edhe i kemi hypë aeroplanit e jemi kthye.

E tash, qatë ditë që e bindëm me ardhë knejna, e kish marrë edhe grun me vete në biseda. Edhe tha, “Gru, bonu e sinqertë edhe prano se ti kurrë nuk ke qenë në negociatat e mia me u angazhu në ndonjë klub apo reprezentacion, po është hera e parë që ke ardhë sot qetu. E unë po të tregoj arsyen pse ke ardhë sot qetu, për me të bind që kom punë me punë të rëndomta, si unë edhe ti, e jo si i parafytyrojnë shqiptarët e Kosovës.” [Një moment krenarie dhe reflektimi mbi mënyrën se si i paragjykonin shqiptarët nga Kosova në atë kohë.] U nisëm në mbramje, erdhëm në aeroport të Lubjanës, aterimin e parë e patëm. U nalëm, po kalojmë për doganë, unë i pari si shef bejgi, thashë: “Unë po.” Tha, “*Šta ima?*” (Çfarë keni?) I thashë, “Ćiro,” thashë, “nuk qenka bash dhuratë e vogël,” thashë, “qeta e kom.”

E ja nisën, po keshin ata edhe e ditën që hajgare ajo punë. E kemi vazhdu deri në Beograd me aeroplan tjetër, e prej Beogradit me kerr të Elektroekonomisë së Kosovës jemi nisë për Prishtinë. Jemi nalë në Krushevc, jemi hi në një bar të natës, a beson, Edmond, si e kanë hetu, kishe po dojnë me na hangër për së gjalli, me përqafu, qo pije anena e knena, tu bo, nuk kanë qenë tu na lëshu. E dikur i thashë: “Ec

more, ec se u bo vonë,” se kishim me mri në 8 ora, e ish ora diçka 2 e mëngjesit. U nisëm kadale-kadale, edhe mrri’m në Lluzhan, para se me mbrri mbi urë të Lluzhanit.

I thashë, “Ćiro, do me të pyet diçka.” Tha, “Vetëm çka ki me m’vetë?” I thashë, “Për çka është i njohun ky vend?” Më tha, “Ti me të vërtetë je idiot, për Zotin, qashtu është, po m’vozisn majmunin natën, e nuk e di ku po m’çon, e po m’pyet për çka është i njohun ky vend!” I thashë, “Mirë de, ti je i mençur, e nëse nuk e din, më pyet e të tregoj. Rreci,” thashë, “ky vend është i njohur se unë kom lind edhe jom rritë qetu, edhe e kom kry shkollën fillore te kjo shkollë.” “Jooo,” tha, “të ja ka nisë e m’shojke kres, po ti ishe idiot, ti ishe kidnaper, e anena e knena!”

Erdhëm në Prishtinë, shkoi në Grand, u vendos e i ndrruoj teshat, se kishim në tetë drejt e në Kryesi. Si hymë, “*Dobro jutro, dobro jutro*,” tha, “me pas ardhë,” tha, “krejt kjo Kryesi, çka ka bo ky njeri me m’pru mu qetu sot, ju nuk kishit mujt me bo,” tha, “nuk e di,” tha, “a e njihni ju mirë,” tha, “kush është, ku e çka është ky.” Edhe ja nisëm aty tash: “Për mos me zgjatë...” Sadik Vllasaliu tha: “Unë kom mendu që je ma korpuent, ma i zhvillum,” tha, “ti paske qenë i imët.” “Eee,” tha, “aj helmet ma të rrezikshme mbahen në boca të vogla.” Edhe ja dha përgjigjen menjëherë, edhe ja nisëm me keshë, e qashtu vazhdoi pastaj puna.

Shkoi, i vizitoi lojtarët, u nis me u kthy qysh tregum, e tani masanej, kur u ardhë, kish pas dalë drejtori i Zvezdës së Beogradit. Deri në mëngjes s’më ka lanë me fjetë, më ka mbajtë në hotel, qaty: “Jo, nuk e ke me shku në Prishtinë! Qysh ti me shku në Prishtinë? Kush është Prishtina për ty? Ki me ardhë në Zvezdë!” Ajo, ajo u kanë fjala. Nuk ka pranë me shku. Kështu që u kanë një situatë e një moment shumë interesant, edhe kjo, e tani e boni atmosferën ma – se u vazhdu, se kishte ra niveli i vizitave, i shikueshmërisë, edhe u mbushë plot stadiumi gjatë kohës së tij. Mbetëm në ligë prapë, edhe shkoi tani ai, edhe gjithnjë tu ra, derisa fillun, erdhën këto vitet ‘81–’80, anena e knena. U bo gjithnjë faqja e zezë ma e madhe. Në të vërtetë, ‘81-shi – jo se u afroshim viteve të ‘90-ta, po mas ‘81-shit filloi tani degradimi te na në Kosovë, jo presionet, jo anena e knena.

Pjesa e pestë

Edmond Sylja: Pas pozitës së drejtorit të klubit, ku kalove mandej?

Mexhid Sylja: Drejtor në Autotransport, në kuadër të Elektroekonomisë së Kosovës. Aty kom shku pa e ditë ku po shkoj tamon e çka më pret, po kom bo mirë, se ka qenë një përvojë shumë e mirë për mu. Se në çfarë gjendje i kom gjetë ata punëtorë, në aspektin e diskriminimit, se presioni hala prej serbëve, edhe të kushteve mizere të punës, edhe dukshëm ja kom përmirësu të gjitha. Edhe ku jonë ata sot, nuk ka shans cili është gjallë e më takon pa u nalë dorë për dore me thanë: “Ku je, drejtor? Ku je, drejtor?”, sikur që ka ndodhë në Elektroekonomi.

Mandej, prej aty kom kalu, më kanë propozu, jo me kërkesë temen, po më kanë thanë duhet me shku në Termoelektranë, se kanë qenë Termoelektranat të ndame në dy sisteme, në dy njësi punuese. Organizata themelore të punëve të bashkuara jonë kanë ashtu. Edhe kem marrë vendim në nivele të Bordit të Drejtorëve, Këshillit Drejtues të Elektroekonomisë, në të vërtetë, me u bo funksionimi i dy elektranave, dy njërive punuese. Edhe punuam në atë ekipin organizativ bashkë me Dautë Shurrën e do kuadro të tjera që jonë kanë, me do organizata, me ndihmën e organizatës së punës së bashkuar, Termocentrali Kosova A dhe B. Jom zgjedhë zëvendësdrejtor gjeneral i termocentraleve. I kemi pas nja 1500 a 1600 punëtorë. Ka qenë një punë shumë me rëndësi, me plot sfida e me plot momente të randa, po edhe kënaqësi.

Pra, sfidat në aspektin pozitiv jonë kanë se u mbyll ai proces me sukses, u bë riorganizimi i punëtorëve që kanë funksionu mirë, kushtet i kishim ideale për punë, të ardhurat personale të mira. P.sh. unë e kom pas rrogën 1700 euro, punëtor nën 800 euro nuk ka pas në atë kohë, marka, të merremi vesh. Edhe për ushqim e këto mos të flasim, transportin e organizum e krejt.

Po fillun tani sfidat, se qato lëvizjet politike në aspektin e Kosovës për ne shqiptarët filluan me u shndërru në një tërmet për krejt Jugosllavinë. Filluan të na merret autonomia e Kosovës, po edhe autonomia në organizatën punuese të Elektroekonomisë – të organizatave të përbërjes punuese: Elektroekonomia e Kosovës, ku jonë kanë minierat, elektranat, dispanzerët, ndërtimtaria e plotë, çka jonë kanë ato, e E-KOS-i. Kështu që filluan ato procese: hajde, hajde, hajde... Në '89-shin më larguan. Në të vërtetë, hoqëm dorë prej partisë, e masi hoqëm dorë e i dorëzuam librezat, u deklarum publikisht që nuk dojmë me qenë ma anëtarë partie e sene. Edhe e morën atë si pretekst për me më largu prej detyrës së zëvendësdrejtorit gjeneral të elektranës. Më larguan aty, një farë bashkëpunëtori ma dhanë, që mos me më largu prej punë krejt, po masanej më kanë largu. E mandej, prej aty, se unë bojsha problem, e organizova sindikatën e sene, edhe më larguan prej punë. E kom fitu atë kontest ma vonë.

E tash, derisa kemi qenë aty, i kemi mobilizu punëtorët për gjithçka. I kom disa kumtesa nëse të bojnë punë diçka, po jonë në serbisht – që kemi shkru se qysh jemi shprehë na dhe si e kemi kundërshtu tendencën e Elektroekonomisë së Serbisë për me e zhbë Elektroekonominë e Kosovës edhe me ja bashkangjitë Elektroekonomisë së Serbisë. Edhe ja patën arritë qëllimit diku në '90 e diçka, edhe ka funksionu ashtu, si pjesë e Elektroekonomisë së Serbisë.

Protestat kanë qenë gjithfarë, si mbylljet në salla, duke protestu publikisht, mos me punu disa sektorë. Edhe derisa mbërrini situata me këta minatorët e Trepçës, u solidarizua me ta. E atëherë fillun presionet, shantazhimet në mënyra të ndryshme, marrja në pyetje e punëtorëve, ekupe të tëra të sigurimit shtetëror duke u sillë. I kordinonsha ato punë vetë, e kuptohet, me disa djem që jonë kanë të jashtëzakonshëm aty. Edhe patëm mbërritë, këtë ja vlen me përmend, që kemi qenë të parët që kemi fillu organizimin e Sindikatës së Pavarur.

I ndjeri Bajram Gjonbalaj ka qenë një punëtor i elektranave, Edmond Dyla, Mond Mani, edhe nuk e di cili tjetër u kanë... Kanë ardhë, thanë, “Qeshtu, qeshtu.” E kemi siguru një statut të elektranave të Sevonjës, ka qenë një qytet i vogël, një subjekt pune, edhe e kemi marrë atë statut, e kemi fillu organizimin sindikal. Ndërkohë ka ra ideja, “Hajde, po shkojmë, po konsultojmë me dikë, se çka po ja merr mendja.” Ju kom rekomandu me shku te Bardhyl Qaushi, profesori i ndjerë, që unë e kom pas profesor, ka qenë profesor në Fakultetin Juridik. E kanë mytë serbët atë. Edhe kanë shku ata në Fakultetin Juridik.

Nuk e kanë gjetë, e zbresin poshtë, e kanë taku Hajrullah Goranin. “He djema, çka po bëni, kush jeni, kah keni kështu?” “Valla, qeshtu, qeshtu, te Bardhyl Qaushi, profesori.” “Po çka patët me Bardhylin?” “Po qeshtu, qeshtu, qeshtu.” Thotë, “Uuuuuu, shumë ide e mirë!” Edhe i merr, i shtin në zyrë të vet, edhe qaty Hajrullah Gorani e ka përvetësuar idenë tonë, edhe mo nuk e ka lëshu, e vet u paraqit si koordinator e sene. Po na nuk kemi ditë atëherë me i lujtë ato lojna, me thanë, “Pse unë e nisa i pari këtë punë?” A Hajrullahi ish kanë pikërisht asi lojtar. Edhe ai. Mirëpo, e kemi përkrahë tani me maksimum. Edhe kom qenë një ndër ata që e kom kry punën ma të madhe për përpilimin e statutit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Tri versione i kom pregatit vetë, derisa është aprovu versionin i fundit. Edhe ndërkohë, kur i pam do lojna të Hajrullahit, e bona një grup unë, Agim Hyseni, Ilir Tolaj, një i postës u kanë, edhe nuk di kush tjetër. Demonstrativisht u prishëm me të edhe u tërhoqëm prej tij. E bëmë një kumtesë edhe jemi dalë prej sindikatës. Edhe mandej vazhdoi qashtu me lojna të veta.

Edmond Sylja: Për cilin vit po bëhet fjalë për këto ngjarje që përmende?

Mexhid Sylja: Këto kanë qenë vitet e ‘89, më kanë largu mu prej pune. Diku ‘88, atëherë kur kanë qenë këto ndryshimet e statusit, e shuarja e autonomisë së Kosovës, e Elektroekonomisë, e krejt. Në ‘89 më largun prej punë, bona padi në gjykatë, e pata fitu, edhe kom nejtë nja dhjetë vjet pa punë, domethonë, s’kom punu kurgjo hiç. Prej ‘89 deri në përfundim të luftës nuk kom punu, e kur ka përfunduar lufta, kom fillu në Komunë të Prishtinës.

Edmond Sylja: Qysh ke kjo periudhë prej 1989 deri në përfundim të luftës? Çfarë aktiviteti keni pas gjatë kësaj kohe?

Mexhid Sylja: Po shiqo, kom pas provimin e juridikaturës që e kom dhënë në 1975 edhe kom mujtë në çdo kohë me dalë avokat, siç jonë kanë edhe avokatë tjerë. Mirëpo, nuk ma ka marrë mendja me shku me punu në ato gjykata kur krejt gjykatësit shqiptarë u largun edhe dhanë dorëheqje, edhe me shku n’për gjykata serbe. Edhe nuk po thom tash se s’ka pas avokatë shqiptarë që jonë shku edhe jonë mundu me i mbrojtë personat që dënoheshin, po edhe ajo mbrojtje u kanë sa për sy e faqe, se nuk ka pas kurrfarë efekti. Edhe mu nuk ma ka marrë mendja, nuk kom pranë me shku, jom marrë me punë private.

Një pjesë të madhe e kom kalu qitu në katun, kemi pas katër hektar tokë, jemi kanë bashkë atëherë me Rushitin, me Abitin e sene, edhe e kom punu tokën. I kom siguru 15.000 marka në atë kohë për çdo vjet, kompira, misër, jo anena, jo knena. Shitoren e kishim atje në Prishtinë, e kemi kalu qashtu, e nuk kemi pas problem në aspektin material. E kemi kalu mirë, deri që ka përfundu lufta.

Edmond Sylja: Cili ka qenë aktiviteti i juaj në demonstratat e marsit 1981?

Mexhid Sylja: Në '81 nuk kom pas aktivitet, se kom qenë në Komunë të Prishtinës. Mirëpo, jemi mundu me ju ndihmu edhe me minimizu problemet, që mos me ju dhanë kahje tjetër, por ajo ka qenë e pamundur, se ka qenë punë e politikës. E unë kam qenë anëtar i partisë, po si jurist e kom pas punën si sekretar i Kuvendit, mandej për Urbanizëm, e një kohë si sekretar i Këshillit Ekzekutiv e sene. Kemi pas ndoshta ndonjë angazhim ku kemi shku në ndonjë bashkësi lokale me bisedu rreth situatës, edhe i kemi tregu: keni kujdes me kë po rrini... po çdo aktivitet ka qenë atëherë i pamundur, se ka marrë përmasa tjera.

Edmond Sylja: A doni me nda diçka rreth kësaj periudhe, prej daljes nga puna deri te zhvillimi i luftës?

Mexhid Sylja: Me të thanë të drejtën, nuk po më kujtohet. Jemi kanë si krejt tjerët, në atë rezistencën pasive e sene. Rreth këtyre kontributeve, e kemi pagu vazhdimisht 3%. Në një mënyrë u tërhoqa, se kom pas mundësi me u kyç, mirëpo u tërhoqa.

Edmond Sylja: Për çfarë arsye vendosët me u largu tërësisht prej aspektit politik?

Mexhid Sylja: Prej aspektit politik, unë kom vendos me u largu masi ka përfundu lufta. Unë isha kryetari i parë i Komunës së Prishtinës.

Edmond Sylja: A mundesh me na tregu qysh ndodhi kjo periudhë?

Mexhid Sylja: Gjatë luftës, të merrim vesh, që kur kanë fillu celulat e para, në Komunë të Podujevës kom qenë vazhdimisht i lidhun me ta, përmes Fatmir Humollit, përmes Shefqet Humollit. Muhamet Latifi ka ardhë vazhdimisht në odë; aty ka ardhë herë vetë, i dyti a i treti. Kemi bisedu rreth organizimit, rreth mundësive, se çka mundemi, qysh me u gjindë në momente edhe situata të caktuara, qysh me qenë ma vigjilent, se frigoheshim prej ndonjë aksioni të befasishëm a diçka. Jo që kishim ndonjë plan të madh, po thjesht me mbajtë popullsinë ma vigjilente ndaj situatës. Një kohë ka pas edhe janë organizu roje nate në krejt katunin, e ka ditë kush ka me rujtë në filan natën, e kush në mahallë knena, e qashtu kanë qenë ato. E qysh ke pytja, më fal?

Edmond Sylja: Para se me fillu me tregu punën si kryetar, qysh ke kjo periudhë e luftës për ju?

Mexhid Syla: E, periudha e luftës, thash që kom qenë në kontakt me ta vazhdimisht. E kemi shku kur kanë dalë në Zabërgjë, është në Bajgorë ai fshat, atje është e vendosur një shkollë. Me Shefqet Humollin kom shku tri herë atje. Herën e parë kemi shku me Shefqetin, edhe është mbajtur një takim i komandantëve. Dikur prej komandantëve kanë qenë eprorë, ky Idriz Shabani, komandant Luta që e ka mbajtur atë takim, edhe komandant Daja, rreth asaj se çka është detyra jonë si koordinatorë për fshatra edhe lokalitete të caktuara, me lajmëru nëse ka naj problem, ose ndonjë person në devijim, edhe eventualisht kuadrat apo ushtarët që mundën me u mobilizuar ose thirrë, që ofrohen për me shku, a me i pranuar a mos me i pranuar.

Ndërkohë Iliri, Blerimi [djali i tij], me vete më tha, “Babë,” tha, “qeshtu, qeshtu, me Ilirin kom biseduar edhe du me të njoftuar, edhe normal, edhe me të vetë çka po thu, se unë kom vendos me ju bashku edhe me ju bashkangjitur UÇK-së.” Thashë, “Po, ma mirë koka kanë mos me më njoftuar hiç, se me të thanë mos shko, nuk muna me të thanë, e me të thanë shko, e po të ndodhë diçka, nashta mos po thom najherë, “bile mos t’i kisha thanë”. Po që nuk mundet me u përjashtuar ajo rrethanë, se dihet për çka shkon. Edhe kur shkon njeri me ju bashkangjitur ushtrisë, edhe në luftë, thashë, rreziku potencial është me përfunduar qysh përfundohet. E për hajër i qoftë, e inshallah ju prin e mbara, thashë, e vendimin merre vetë.”

“Jo,” tha, “unë e kom marrë vendimin, edhe nesër a masnesër...” E kanë marrë një çantë shpine edhe i kemi marrë, i kemi çuar deri në Dobratin me Shefqet Humollin. E kemi kaluar bile edhe Dobratin, edhe jonë shku djemtë atje. Edhe mandej kemi shku edhe dy herë me Shefqetin, i kemi marrë do sene, i shtishim në gepek, e ja kemi çuar, për qeto informata që i thashë në këto mbledhje.” Ndërkohë, këtu ka ardhë Muhamet Latifi vazhdimisht me biseduar, këtu në shpi, edhe kom nejtë me të, vazhdimisht kom diskutuar e biseduar për gjana të ndryshme. Madje, Fatmiri më ka thanë, “Mexhid, a munesh me na punuar një rregullore për funksionimin e pushtetit lokal në rrethana të luftës?”

Jom ulë bashkë me shoktë e mi, Bajram Tmavën edhe Qazim Qerimin. Kemi punuar një dy-tri netë edhe e kemi bërë një rregullore që mendoj ka qenë shumë e mirë. E kemi shtypë në zyrë te Bajrami edhe ja kemi dhënë Fatmiri. Mo, tani filloi situata me u ashpërsuar gjithnjë, e me marrë kahje tjetër, filluan luftimet anej-knej, e nuk e di a e kanë diskutuar a çka kanë bërë, por e kemi punuar atë. Në këtë drejtim, po mendoj që kom pas kontakte vazhdimisht me të ndjerin Hyzri, rahmet i pastë shpirti. Tri ditë para se me u vra, jom takuar me të te një lokal te Qafa. Ka qenë me dy shoktë e tij që u vranë me Ilirin, edhe këtë gazetarin, po ja harroj emrin.

Kemi biseduar gjonë e gjatë me të, edhe më tha: “Përveç tjerash, Bal,” se Bal m’thojke mu, tha, “Kom vendos edhe i kom bërë krejt përgatitjet me e marrë stacionin e policisë në Podujevë. I kom njerëzit mrena.” Thashë, “Inshallah ndodhë ajo, po duhet kujdes i madh, se goxha operacion i komplikuar duhet me kanë ajo punë.” “Po, po,” tha, “po, jonë kry punët krejt.” E nuk zgjati tri ditë, e thanë, “O valla, u vra Hyzri, u vra Afrimi, e Iliri...” Çka me bërë? Kom shku në Institutin e Mjekësisë Ligjore, mora

vesh që Tefik Gashi ka me kry obduksionin. Me Tefikun jom njoftë qysh kom qenë gjyqtar, edhe jemi kojshi te Dugoja, ku i kanë djemtë e Abitit, aty [bëhet fjalë për lagjen Dardania].

U lajmërova edhe shkova, i thashë: “Doktor, kështu, kështu, kështu,” edhe i thashë, “Hyzrin e kam sipas kësaj vije të njohun, Iliri është djali i Ilmi Durmishtit, Ilmin e kam shok, edhe ky djali është shok i tyne. Jam i interesum me i pa ato kufoma një herë, por edhe kur t’i pranosh me bo obduksionin.” “Po,” tha, “s’ka problem.”

Kom shku poshtë, i kom shpëlu e i kom pa edhe me duart e mija, bashkë me atë punëtorin e kapelës edhe dikush prej familjes së tyne na ka ndihmu, se s’kishte edhe njerëz atëherë. E kemi çu në sallë, se qysh kanë qenë ata të dërrmuar fizikisht prej plumbave *dum-dum*, e çka janë ato... Është bo obduksioni, e kom ble qefinin për të tre, i kom marrë, i kom pshtjellë edhe i kom qitë në kerr aty, edhe i kemi çu në Llapashticë, ua kemi dorëzu në zonë atje. Janë përshtëndetë me ta, i kanë falë ato xhenaze. Ilirin e ka marrë babai i vet edhe e kanë varrosë në Shajkoc, në vend të vet. Hyzrin e kemi varrosë në Letancë, edhe ai djali tjetër, nuk e di ku është varrosë, ai gazetari. Këto janë disa prej momenteve më të rëndësishme... po tash, unë krejt kohën kom qenë në Prishtinë, nuk jom largu kurrë.

Edmond Sylja: Edhe gjatë luftës?

Mexhid Sylja: Po, edhe gjatë luftës. Nji herë jemi hypë në tren me shku për Shkup, kur s’met më gati kërkush. Nuk e deshti fati, kemi shku deri në Han të Elezit, edhe u nalë pak treni. U frigum, se mos po na hinë, qysh i seleksionojshin, mirëpo nuk ndodhi ajo. Na kthyn, edhe kemi mbrri diku në dymbëdhjetë të natës në Prishtinë. Gjatë kësaj kohe sa kom qenë në Prishtinë, vazhdimisht kom kry punë të mëdha. Kom qenë në lidhje të vazhdueshme me këta të zonës operative të Llapit. Kom qenë aktiv, u kam dhënë informata për familje, mas pari për familjen teme: ku janë, çka janë, çdo detaj e kom ditë, ku jonë e çka bojnë.

I kom organizu këta të mitë çka jon kanë në Prishtinë, i kom qitë Blerimin me Bujarin, edhe nuk e di kush tjetër, i kom qitë në autobus edhe jon shku për në Maqedoni. Ndërkohë Nexhatin, Armendin edhe Xhetin i ka marrë Rushiti, i ka çu deri në Stanofc, për me ju bashkangjitë UÇK-së në Majac. Atje jon kanë krejt derisa i kanë ndjekë prej Majacit. Këta i kanë bajtë të plagosurit prej Majacit deri këtu te ushtria në Vranidoll, e aty i kanë marrë tjerët, e aty u kanë thanë, “Vallahi, shkonin kah të mundeni, se nuk po dimë kah me ja majtë,” edhe jon ardhë në Prishtinë.

Prej Dardanisë jom shku te bacë në Vranjencë, këta jon kanë vazhdimisht, i kom çu sende. Hakifin e kom gjetë ditën e Bajramit tu hangër, e njerëzit sa mujshin dilshin e ikshin kah Tophanja, ku u kanë i vendosun te miqtë e vet. I thashë, “Çu, Hakif, mos prit mo, se nuk është situata për me prit.” Krejtve ju kom thonë, e vetë kurrë nuk ma ka thonë zemra as goja me dalë. E atëherë erdh puna që mo nuk kishim, u zbraz gati krejt. U kthyem prapë, nuk na kanë provoku. Policinë e kemi pas në podrum,

ndoshta edhe fati jonë që kemi pas, jon kanë polici e rregullt e nuk jon kanë ata paramilitarët, se ku ishin ata, bojshin damin ma të madh.

Nata ma e hareshme, s'ka pas hare aty, po ma e gëzueshme, po, edhe gëzim edhe hidhërim e kemi pas kur kanë hy, kur ka fillu NATO me bombardu edhe kur u nënshkru marrëveshja. Eh, nata ma e gëzueshme u kanë kur kanë fillu me ra bombat e para, që filloi NATO me bombardu, u thirrshim në telefon, "O ja nisen dardhat me pikë anena, knena!"

Kthehem tash te kjo nata, masi u nënshkru marrëveshja... atë ditë, tanë ditën, fillun lajmet që janë nisë një njësi e këtyne ushtarëve rusë prej Bosnjës me ardhë në drejtim të Kosovës, edhe vazhdimisht lajmet u përcjellshin, "mrrinë këtu", "mrrinë atje"... Na, sa u gëzum që u nënshkru marrëveshja e po ndërpritej lufta, na e prishi ajo. Edhe kur erdhën në Prishtinë, dolën te Teatri e u tubun shkijet me flamuj e sene, e na ishim në Dardani kur kanë ardhë kah Dardania. Ata qëllimin e kishin pas me shku në aeroport, edhe te aeroporti përballë është një hangar, ndër më të mëdhenjtë në Jugosllavim, i ushtrisë u kanë, aty ka pas aeroplanë të vendosun. Kanë kalu atypari... edhe me të thanë të drejtën, atëherë u dorëzuam. Më kapi një farë treme, një farë rrenqethje... edhe ndodhi qysh ndodhi, çka u bë, ajo punë.

Edmond Sylja: Çfarë ndodhi me këto trupa rus dhe me protestën që u mbajt? A pati ndonjë ndikim?

Mexhid Sylja: Nuk ndikoi ajo kurgjo, se nuk zgjati, hyni pastaj KFOR-i, se KFOR-i u merrke me atë punë. Po normal, na u frigu kur i pam, pse me ardhë ata, e qysh po bëhet kjo punë? Na pengojke shumë. Gjatë luftës, një herë jom nisë prej Prishtinës me Fahri Tallen, kemi shku në Koliq. Atje ka qenë një situatë me qindra çadra të vendosuna, sa familje, sa njerëz... Prindërit e mi s'kom mujt me i pa se ata ishin nisë për Prishtinë, e nuk kom mujt me pa kërkon. Po kom pa familje të tjera, e kom marrë informata për krejt, tanë i kom njoftu, "Qeky është qetu", "Qeky është qetu."

Pjesa e gjashtë

Edmond Sylja: Qysh erdh puna që pas luftës me qenë kryetari i parë i Prishtinës?

Mexhid Sylja: Mas hyrjes së NATO-s, normalisht dola. Qyteti u dukej i boshatisun krejt, rrugët plot, tu i prit forcat e NATO-s. Jom nisë, jom dalë deri në Vranjevc. Kolonat e serbëve pa ndërpre tu ecë, do armë i mbajshin në dritare për me u mbrojtë e sene, po KFOR-i nuk lejonte diçka, veç i shajshin. Dy herë jom ardhë në katun, se nuk mujta pa ardhë, edhe nuk po e thom atë trimni, po budallaki, se qashtu jom unë, i dhanun me këtë katun. U morëm vesh që kanë ardhë këta të Zonës Operative të Llapit në Sofali e janë vendos. Kom shku me Zenun Çelën edhe Fahri Tallen me i vizitu, u përshëndetëm, u përgëzuam njëni-tjetrin, normal, na i përgëzuam ata e i falënderuam.

Duke bisedu, Remi tha, “Komandant Mexhid, u bë çka u bë, ne kemi bërë diçka, na ndihmoi kush na ndihmoi, erdhëm këtu. Ne pushtet me organizu nuk dimë. Nuk ke mundur ta dëgjosh prej asnjë komandanti të asnjë zone ta pranojë këtë realitet, por të gjithë i kanë shpallur vetes titullin kryetar, njëri ka qenë në Shqipëri e është shpallur kryetar i Prizrenit, tjetri diku tjetër, e tjetri po ashtu. Ne kemi marrë vendim për Prishtinën që ti ta bësh ekipin. Dhe të lutem, prej sot i ke të gjitha autorizimet për të filluar e për të bërë diçka.”

Me të thonë të drejtën, e dija çka do të thoshte ajo punë, se kisha përvojë, kisha punuar në komunë. Në ato rrethana, me refuzu nuk munda, dhe i thashë, “Rem, po shohim, nuk po i ikim përgjegjësisë,” thashë, “veç na lejo pak kohë, se duhet me bisedu edhe me disa njerëz që kanë më shumë përvojë, e ndoshta bëjmë një zgjidhje më të mirë.”

Normalisht, kom mendu për Muhamet Mustafën. Kom shku tri herë te Muhameti, i kom thënë, derisa m’tha, “Mexhid, nuk muj, se e kam një projekt në emër të Inkosit prej USAID-it, kom marrë pare dhe s’kam çare pa e kry.” A e ka pas për atë arsye, a e ka pas që s’ka dashtë me hy në ato rrethana, nuk e di, po le të mbetet në ndërgjegjen e tij. Kom shku edhe te Asllan Baruti, ka qenë sekretar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, edhe atij ia kam thënë, por nuk ka dashtë me ndi, tha, “Jo, Mexhid, nuk muj.”

E tani ja kom nisë vetë asaj pune. Hajde, hajde, biseda andej e këndeje, qysh me ja bo, çka me bo. Mas pari kemi pas problem me kontaktin KFOR-in, se për një kohë këta të UNMIK-ut si administratë civile janë vonu derisa kanë ardhë e i kanë caktu njerëzit e vet, e s’na lejshin me hi në ndërtesën e komunës. Janë kanë një kolonel, Nill, edhe një tjetër.

Edmond Sylja: Për çfarë arsye?

Mexhid Sylja: Për shkaqe sigurie, se hala kish serbë e pretendojshin. U kanë një Zorana Živković, kinse kryetar i Komunës së Prishtinës, ai legal, e nuk u pajtojke që e ka hangër ujku atë punë. Kemi bisedu edhe e kemi zgjatë deri në mujin e gjashtë a të shtatë këto biseda. Ka ardhë mandej administratori lokal, një amerikan, Jay Carter, administrator regjional për komunat Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Podujevë, u kanë një Enrick Aguilar. Me ta kemi komunikuar, normalisht edhe me të KFOR-it, qysh me ja bo, e neve na e kanë mundësu me hi edhe me pas një zyrë në komunë. Kemi hi edhe kemi fillu me i mbajt ka pak takimet aty, se në rrugë s’mujshim me i mbajt. Edhe ai ka qenë suksesi i parë, se tjetërkund kanë pas problem ata që kanë mendu me i injorua ata.

Më thanë, “Jo, na s’ves KFOR-in e UNMIK-un, ata jon nda keq, ata kanë punu në koperativa, nuk kanë guxu me ju afri, ose Kadri Kryeziu e kanë qitë, masi ka punu katër-pesë muaj, ja kanë rrethu krejt ndërtesën edhe i kanë thanë që në përimetër të caktum nuk guxon asnjë punëtor e as ti me ju afri.” Në qato kushte u deshke me komunikuar me njerëz, me ju dhan ndonjë informatë, ka pak çka dijmë, se nuk kishim mjete financiare, nuk kishim kurrfarë. Mandej hymë në negociata me ta se qysh me ja bo e çka

me bo. Kemi bisedu me muaj të tanë derisa kemi arritë një marrëveshje për kthimin e disa punëtorëve në vend të punës.

Propozimi i parë ka qenë 80 me 80, 80 shqiptarë me 80 serbë. Normalisht, e kemi refuzu atë. E shihsha që nuk po vinte asnjë serb dhe e dija që nuk kish me ardhë asnjë, por thosha, të paktën le të mbetet e dokumentuar se çka kanë propozu. Pastaj kemi pranu 80 me 40, me kusht që të përfillet struktura e popullsisë, numri i të punësuarve me qenë në përpjesëtim me strukturën e popullsisë sipas regjistrimit të vitit 1981. Ajo ka qenë 80 me 20, dhe unë kam qenë zëvendës anëtar i komisionit për regjistrimin e popullsisë në komunë të Prishtinës, kështu që e kisha të njohur atë fakt, dhe u morëm vesh ashtu.

Fillum pranimin e punëtorëve, nisëm me ua lëshu vendimet atyre që pranoheshin. U përpoqa disi me na siguru mjete e gjëra, por në atë drejtim kam qenë i urtë, thosha, mos po më keqkuptojnë, por kam gabu aty, se nuk mundesh pa para me punu. Kanë marrë disa para prej shërbimit të kontabilitetit nga llogaria e komunës, çka janë gjetë, i kanë tërheq ata, se edhe në bankë e në institucione të tjera ishin ndërkombëtarë, i kanë tërheq edhe ua jepnim punëtorëve pak nga pak, ashtu.

Nuk e di në cilin muaj, por duhet me kanë muaji i tetë i vitit '90, edhe kemi arritë me bo një marrëveshje për strukturën organizative në komunë, në secilin drejtorat ka me kanë një ndërkombëtar dhe një kosovar. Normalisht, kemi qenë krejt shqiptarë, se serbët nuk kanë ardhë asnjëherë në punë. Një zëvendëskryetar e kam pasë, ishte prej Llapnasellës, ai ka ardhë ndonjëherë, ka nejtë aty edhe thoshte, "Mexhid, mos ma shi për të madhe." Po, shkojshim edhe mundoheshim, i kemi bo disa punë kadale-kadale, me i vizitu e me pa sa janë dëmet. Kemi bo një regjistrim të dëmeve, kemi qenë komuna e parë që e ka bo atë regjistrim, edhe rastësisht gjeta një shkrim që thoshte se është bo në bazë të një standardi dhe metodologjie që kanë punu këta ndërkombëtarët. Rexhep Luci ka qenë bartës i kësaj pune krejt, edhe u bo regjistrimi i dëmeve, edhe në njerëz, edhe në bagëti, edhe në dëme materiale: në shtëpi, në traktorë, e ku ta di unë. Janë përfshi ato të dhëna, edhe ka shumë punë të tjera që janë kry, çka kemi mujtë, tash s'më bie në mend krejt.

Ja fillum me meremetu bazenin në Gërmi, e do çerdhe e do shkolla u hapën, e fillun ashtu kryesorja me funksionu në ato kushte e rrethana shumë të vështira. Derisa u mbajtën zgjedhjet, u mundojshim me nalë ndërtimin pa leje se fillun njerëzit sa mujshin me ndërtu e sene. 40 objekte i kemi rrënu e ndalë që i nisshin, mirëpo kur erdhi një farë Brege, një farë gjermani, ai ish pas kanë faqja e zezë – ai na shkatërroj çdo gjë, e dështoj aty.

Edmond Sylja: Në çfarë aspekti?

Mexhid Sylja: Nuk lejojke, jo, thojke, unë vendosi, se mirë po punojnë, se krejt i ka pas autorizimet. Pa urdhër të tij s'u bojke, se në Rambuje u patën definu ato sene se kush është zot shtëpie një kohë këtu, në administrim ndërkombëtar, edhe ata vendosshin për këto punë. E mora e qita nëpër qytet krejt, i

vizitum qeta e qeshtu: kjo pa leje, kjo pronë e komunës, e këtu u mbindërtu. “Jo,” tha, “se po u ndërtojka sipas standardeve evropiane, e mirë është puna.” E dështoi pastaj ajo punë.

Fillun zgjedhjet e unë konkurova për deputet në Kuvend të Prishtinës, bile jom kanë i pari në listë. U kanë Aleanca, Lëvizja për Bashkim Kombëtar, e u patën bo parti të hamamit, e qaty unë, shkaku i Fatmirit, hina e jom kanë i pari në listë edhe kisha një respekt e autoritet. E ata ishin kap në mes vete qeta Klinakt të Mazgitit, këta ishin kanë qenat e krejt qenave, këta ishin kanë të burgosun politik, po të etshëm për pushtet.

Edhe po m’thotë Fatmiri, “Mexhid,” tha, “a bon me qitë qitë Klinakun, profesor në shkollë të naltë pedagogjike?” I thashë, “O Fatmir, qitne kon t’doni se nuk jom unë i interesum me kanë mo në ato, se unë e kom përjetu shumë rëndë atë punë. Nuk kom mujt me kanë indiferent me krejt këto, njerëzit lypshin ndihmë për anëtarë të familjes, më ka hupë e për kta s’kom, e ato s’kom, ti s’ki mundësi me ju ndihmu kurgjo, po na mirëkuptojshin, shyqyr që na mirëkuptojshin.”

E bomë atë organizim e fillum me u zhvillu dalë-ngadalë. Unë atëherë atij Brent në mbledhje i thashë, “Ma nuk munden me punu me ty. Ju propozoj këtyne të LDK-së,” thashë, “hajde, po e lypim largimin e tij, unë po i cek arsyet për çka.” “Ani,” tha, “qu ti se po të përkrahim edhe na.” U çova, si hyna anena, as nuk më përkrahën, as nuk guxoftën me hi anena, edhe mo u tërhoqa prej atij këshillit koordinues si kryetar i atij këshilli koordinues, se nuk kom thonë kryetar komune asnjëherë. E tash mos të harroj që qetu e kom shkrimin. Ndërkohë, mas filloi ky farë konstituimi, u diskutua puna, çka me bo, që në vend të kryetarit kush me kanë, edhe u bo një thirrje publike me konkuru kush është i interesum.

Ato partitë politike i dhanë, Edita Tahirin, LDK-ja, Fatmir Limën, PDK-ja. Dy kandidatë ma të fortë nuk kish ku shkon, edhe unë isha si kandidatë që isha aty. Unë kisha deklarë që nuk du me qenë mo, ky administratori tha, “Jo, ti ki me kanë aty,” edhe me kanë kandidate, edhe qetu është deklarimi i tij. Edhe apet m’ndalën mu edhe m’zgjodhën deri sa kaloi kjo farë faze. E kemi organizu marshin për Mitrovicë, u kanë një diçka shumë interesante ajo punë, qysh e patëm bo atë punë e sa njeri u pat nisë prej këtu e në Mitrovicë me shku në kambë e sene. Jon kanë plot tjera sene, po që nuk po m’kujtohen.

Edmond Sylja: Qysh ka përfundu periudha e menaxhimit të Prishtinës?

Mexhid Sylja: Periudha e menaxhimit të Prishtinës ka përfundu qetu. Funkcionimi ka qenë vetëm në aspektin e organizimit, qysh me u organizu, edhe kontributi jem ka qenë që kom vu kontakte edhe kom bo kontakte me ndërkombëtarët edhe nuk kom qenë refuzues. Se kemi pas problem, për shembull shkojshe ti te Ramë Buja, ish ministër i pushtetit lokal, ardhke ai i Lipjanit e thojke, “Zotëri ministër, m’u ka ardhë KFOR-i i Suharekës, u kanë një burrë shumë i mirë, ma ka mbyllë zyrën me gozhda edhe më ka qitë prej zyrës.” Çka me bo, thojke?

Ç'ke more ti me KFOR-in, ç'ke more ti me UNMIK-un, ja ku e ke qeverinë e përkohshme. Qeveria e përkohshme nuk kishte kurrfarë kompetencash. Formulisht, e kom këtu një farë vendimi, tri-katër muaj e patën shty punën e kësaj letre me m'lsu shkaku jem, se dojshin me pru dikun në Prishtinë. E patëm shku me Fatmirin (Limaj), Fatmiri veç se e gjeti Hashimin (Thaçi) aty. Se ke q* nanën me u bo horë me to, se dojshin edhe Prishtinën me hi. E tani aty unë i pashë do sene shumë, se çka jon këta të gatshëm me bo edhe arsye se për çka jom tërheqë definitivisht.

Unë, për me vjedhë e me bo, duke e keqpërdor pozitën, kom mujt me bo, se të kallxova çfarë pozitash kom pas ma përpara. Tri-katër vjet e kom udhëheqë urbanizmin e komunës së Prishtinës, nuk ka bir nane që del e që munet me thanë, përveç një Mustaf Gashi, që ja kom pas dhanë lejen për shtëpi qetu te shkolla Vukaragjiq, jo kjo shkolla fillore "Elena Gjika" tash, edhe shkolla e mjekësisë u kanë, ja kom pas dhanë lejen për shtëpi se u kanë vëllai i atij Raif Gashi që ta përmenda në fillim.

Se nuk ka kush që mundet me thanë që kom përfitu, e këta i pash që ishin të interesum edhe ja nisën me vjedhë. Kom bindje që tjetër send s'kishin mendu gjatë luftës veç kush çka me nxanë. Marshin për Mitrovicë e kemi organizu si komunë e Prishtinës, se dola me i vizitu me pa çka po bojnë, edhe shkova ma së pari në Mitrovicë.

Kur shkum, kush u kanë kryetar atëherë? Bajram Rexhepi. Nuk e gjetëm, ishin kanë do bashkëpunëtorë të tij edhe ja nisën me u anku, "Valla kështu, nuk po na përkrahë kërkush e s'po dimë çka me bo, e çka mundemi me bo." Tha, "Nuk po dimë, një farë proteste..." Edhe qaty ka lind ideja me Selatin Novosellën, a bon me bo një protestë me organizu në Prishtinë a dikun. Duke e diskutu, edhe tani i kom organizu se ma lanë mu, i thashë Pajazit Dushit, rahmet i pastë shpirtin, profesorit që u kanë kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i thashë, "Profesor, ti ki autoritet ma shumë. Unë kom edhe qeto obligime, po nuk po i iki prej përgjegjësie, po aman merre për shkak të autoritetit, se je pak ma unifikues." E thashë, "Na ki neve."

"Mexhid," tha, "për Zotin nuk muna," edhe tha, "unë po të thom ty që muj me qenë për çdo mbledhje që të mbajmë edhe çka do që të vendosim e mbështes, edhe kom me mbrojtë edhe kom me u nisë deri ku të mundem, nuk po thom që mundem me shku deri në Mitrovicë." Edhe u nisë deri për te Dragodani, doli në këmbë, e kur u kthye, nuk e di, se na na kapi puna. E jemi shku ashtu, e jemi kanë diku 300.000 vetë, e vlerësojke KFOR-i që jemi kanë. I kom do foto të asaj turme qetu, udhëtojmë, edhe na e kanë prishë Drenicën atëherë.

Edmond Sylja: Për çfarë arsye?

Mexhid Sylja: Dyshoj për arsye se e panë që është një organizim shumë i suksesshëm, se veç kur e panë çka po organizohet e çka po bëhet, ja nis Jakup Krasniqi me deklarata, "Janë organizu," tha, "disa njerëz të ish-sistemit partiak a s'di çka," tha, "diçka." E na i kishim thirrë krejt, edhe PDK-në, edhe LDK-në, edhe krejt kanë qenë në ato takime deri kah fundi, kur e panë se qysh po shkon puna, u

dorëhoqën ata të PDK-së. Na morëm qëndrim me u nisë prej Prishtine, kush don me na u bashkangjitë rrugës duke shku për Mitrovicë, na bashkangjitet, tjetër kah nuk ka me hy në Mitrovicë. Ata kanë hi prej Skenderajt anena edhe si kanë hi, ja kanë nisë me thy edhe e kanë sulmu KFOR-in, ia kanë marrë komandantit të KFOR-it revolen, edhe ata kanë përdorë forcën, edhe mo shkoi badihava, nuk ka pasë kurgjo.

Përveç kësaj, duke mos harruar, si një ndër arritjet që kemi pasur ka qenë miratimi i projektit për ndërtimin e qendrës shumëdimensionale kulturore dhe sportive, në vlerë prej 66 milionëve. Është aprovuar marrëveshja ku kam qenë unë si përfaqësues i komunës me administratorin Jay Carter dhe ministrin për Shëndetësi dhe Punë Sociale të Arabisë Saudite, i cili kishte ardhur në emër të mbretit. Kemi biseduar dhe e kemi arritur atë marrëveshje.

Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Emirateve të Bashkuara për renovimin e Qendrës së Rinisë, rregullimin e pishinës së Gërmisë dhe Varrezave të Dëshmorëve. Çka është me rëndësi, në këto kushte kemi arritur të organizojmë pritjen e Vitit të Ri në ambient të hapur, ashtu si në vendet përëndimore, me ndihmën e vazhdueshme të administratorit lokal edhe për festën e Krishtlindjeve.

Vrasja e Rexhep Lucit ka qenë një ndër ngjarjet që më së shumti na ka tronditur, vrasja e tij në mënyrë mizore, një prej arkitektëve më të mirë të Kosovës dhe një prej ideatorëve të urbanizimit të Prishtinës së re. Ka qenë në Entin Komunal për Projekttime për Urbanizëm dhe, pas luftës, ka qenë në të njëjtën pozitë me propozimin tim, ka ardhur dhe kemi filluar punën me të. Por, mbi të gjitha, kam pasur një vullnet të jashtëzakonshëm, përkundër kushteve në të cilat kam jetuar, kam punuar për të arritur. Motoja ime në jetë ka qenë t'i dua njerëzit dhe të kujdesem për familjen dhe farefisin tim.

Edmond Sylja: Çka dëshiron me nda me ne për fund?

Mexhid Sylja: Përcaktim i im është që kjo lidhje familjare të vazhdojë të kultivohet edhe më tutje në familje, si në raste të ndonjë ahengu apo tubimi festiv, apo në raste mortore, me qenë të bashkum. Andaj jeni edhe ju deshmitarë që sot e kësaj dite ne kemi nje harmoni familjare, e duam njani-tjetrin, bisedojmë për tema të ndryshme, por edhe me luft basketboll edhe në këtë moshë me juve. Preokupim i im ka qenë me ju ndihmu atyre që kanë dashtë me u shkollu edhe këtë e kom dëshmu si me familjarë, po ashtu edhe me farefisin e largët. E tash edhe sot e ndjej kënaqësi kur po ju shoh juve, edhe sa keni qenë jashte Kosovës kom pytë për ju e qysh kaloni, duke u mundu me ju ofru mbështetje morale kurdo që ka pasë nevojë.

Edmond Sylja: Faleminderit shumë, ke kënaqësi!

Mexhid Sylja: Faleminderit Edmond!

